

VËLLIMI XXXIII /PRILL-QERSHOR/ 2026

VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS 2026

BULETINI ZYRTAR



PËRMBAJTJA

Nr.1284, Datë 10.04.2026.....	6
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRIVE AKKIM YAPI KIMYASALLARI SANAYI VE TICARET ANONIM ŞIRKETI DHE AKKIM EUROPE S.R.L. NGA SHOQËRIA SIKAG”	
Nr.1285, Datë 10.04.2026.....	10
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË INFOTELECOM - ALBSOLAR 1 SHPK NGA SHOQËRITË INFO-TELECOM SHPK DHE TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK”	
Nr.1286, Datë 23.04.2026.....	15
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË TV KABLLOR SHIJAKU SHPK NGA SHOQËRIA ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS SHPK”	
Nr.1287, Datë 23.04.2026.....	18
“KËRKESË PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT NGA ANA E NDËRMARRJES TIRANA ADMINISTRIM SHPK”	
Nr.1288, Datë 23.04.2026.....	22
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË EVERLLENCE MUSCAT LLC NGA SHOQËRIA EVERLLENCE SE”	
Nr.1289, Datë 20.05.2026.....	26
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA NGA SHOQËRITË AUCTION HOLDING, A.S. DHE SPV SECOND A.S., NËPËRMJET SHOQËRISË DD RAIL PROPERTIES A.S.”	
Nr.1290, Datë 20.05.2026.....	30
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË VALAMAR TALE 2 SHPK NGA SHOQËRIA BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK”	
Nr.1291, Datë 20.05.2026.....	35
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIA GAS TECH SHA NGA SHOQËRIA JONUZ	

KASTRATI SHPK”

Nr.1292, Datë 20.05.2026.....	40
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRIVE GARANTI BANK SA DHE MOTORACTIVE IFN SA NGA SHOQËRIA RAIFFEISEN BANK SA.”	
Nr.1293, Datë 20.05.2026.....	44
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. NGA SHOQËRIA HEIDELBERG MATERIALS AG”	
Nr.1295, Datë 28.05.2026.....	48
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES SHPRESA - AL SHPK NË TREGUN E TRANSPORTIT URBAN NË BASHKINË KAMËZ”	
Nr.1296, Datë 28.05.2026.....	56
“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1280, DATË 27.03.2026 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË CIGAREVE”	
Nr.1297, Datë 28.05.2026.....	58
“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 1169, DATË 26.03.2025 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES ARLIS ADMINISTRIM SHPK NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË”.”	
Nr.1298, Datë 28.05.2026.....	61
“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 1144, DATË 27.12.2024 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN ACREM SHPK”	
Nr.1299, Datë 28.05.2026.....	66
“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 1168, DATË 26.03.2025 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES D&L ADMINISTRIM SHPK NË TREGUN E OFRIMIT DHE	

AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË””

Nr.1300, Datë 28.05.2026.....69

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 1170, DATË 26.03.2025 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES SAFE SECURITY ALBANIA SHPK NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË”.”

Nr.1301, Datë 28.05.2026.....72

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 1143, DATË 27.12.2024, “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN S&D INVEST SHA”

Nr.1302, Datë 28.05.2026.....77

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË EKONOMIKE TË RRJETIT TË MARKETVE “ECO MARKET” NGA SHOQËRIA SPAR ALBANIA SHPK”

Nr.1303, Datë 26.06.2026.....81

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE I-FIRE SHPK DHE P.F. AERD MAHMUTAJ”

Nr.1304, Datë 26.06.2026.....84

“GJOBITJEN E NDËRMARRJES TIRANA ADMINISTRIM SHPK PËR MOS DHËNIEN E INFORMACIONIT NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1287, DATË 23.04.2026 “KËRKESË PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT NGA ANA E NDËRMARRJES TIRANA ADMINISTRIM SHPK””

Nr.1305, Datë 26.06.2026.....88

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË PREDUZEĆE ZA PROIZVODNJU USLUGE I PROMET UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO, ARANDELOVAC NGA SHOQËRIA WIENERBERGER DOO KANJIŽA”

Nr.1306, Datë 26.06.202692

““MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË MAK MECSEK AUTÓPÁLYA KONCESSZIÓS ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG NGA SHOQËRITË STRABAG AG DHE ABERDEEN INFRASTRUCTURE (HOLDCO) V-A B.V.”

VENDIM

Nr. 1284, Datë 10.04.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRIVE AKKIM YAPI KIMYASALLARI SANAYI VE TICARET ANONIM ŞIRKETI DHE AKKIM EUROPE S.R.L. NGA SHOQËRIA SIKA AG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Denar BIBA	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.04.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të shoqërive Akkim Yapi Kimyasallari Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi dhe AKKIM EUROPE S.R.L. nga shoqëria Sika AG.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërive Akkim Yapi Kimyasallari Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi dhe AKKIM EUROPE S.R.L. nga shoqëria Sika AG”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të shoqërive Akkim Yapi Kimyasallari Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi dhe AKKIM EUROPE S.R.L. nga shoqëria Sika AG.

2. Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, nënshkruar më datë [____], palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: Sika AG** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Zvicrës me objekt aktiviteti: pjesëmarrja në shoqëri të të gjitha llojeve, dhe në veçanti financimi i shoqërive për prodhimin , aplikimin dhe tregtimin e produkteve dhe shërbimeve të specializuara për sektorët e ndërtimit dhe industrisë dhe mund të blejë pasuri të paluajtshme. Shoqëria Sika AG është shoqëria mëmë e Grupit Sika, një grup që ushtron aktivitetin në tregun ndërkombëtar të kimikateve speciale, me seli në Zvicër.
4. Blerësi është aktive në tregun shqiptar përmes shoqërisë [____].
5. **Shitësit:** z. H. A., z. R. A., z. Y. A., z. M. A. A., z. H. H. A. dhe z. M. M. A., individë.

Shoqëritë target:

6. **Akkim Yapi Kimyasallari Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi/ Akkim Turkey** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Turqisë, me objekt aktiviteti kryesor: [____]. Z. Hazreti Akdemir dhe z. Ramazan Akdemir së bashku zotërojnë drejtpërdrejt aksionet që përfaqësojnë të gjithë kapitalin aksionar të shoqërisë.
7. Shoqëria Akkim Turkey ka në pronësi të plotë shoqërinë Akfix Kimya Lojistik Hizmetleri Limited Şirketi.
8. - **Akfix Kimya Lojistik Hizmetleri Limited Şirketi / Akfix** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Turqisë, me objekt aktiviteti kryesor: [____].
9. - **Akde Kimya Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi / Akde Kimya** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Turqisë, me objekt aktiviteti kryesor: [____]. Akde Kimya Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi, kontrollohet nga z. Hazreti Akdemir, dhe nga z. Yusuf Akdemir me nga 50% të kapitalit secili.
10. Përpara implementimit të transaksionit të propozuar, parashikohen disa hapa riorganizimi brenda grupit target për qëllime strukturore ku shoqëria Akde Kimya Sanayi Ve Ticaret Anonim Şirketi do të transferohet shoqërisë Akkim Turkey, pas së cilës Akde Kimya do të jetë një filial i shoqërisë Akkim Turkey.
11. (ii) **AKKIM EUROPE S.R.L. / AKKIM EUROPE** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Rumanisë, me objekt aktiviteti kryesor: [____]. Shitësit përkatës kanë konsoliduar pjesëmarrjen e tyre në AKKIM EUROPE nëpërmjet një shoqërie holandeze me përgjegjësi të kufizuar, rishtazi të themeluar, Atlas Global B.V. (DutchCo) e cila do të mbetet nën kontrollin e anëtarëve të familjes Akdemir.
12. AKKIM EUROPE së bashku me Akkim Turkey, Akde Kimya dhe Akfix , janë shoqëritë e grupit. [____].

II. Përqendrimi

13. Më datë [____], ndërmjet Hazreti Akdemir, Ramazan Akdemir, Yusuf Akdemir, Mehmet Ali Akdemir, Hasan Hüseyin Akdemir dhe Mehmet Mustafa Akdemir, DutchCo (shitësit) dhe Sika AG (blerësi) është nënshkruar “Marëveshje për blerjen e aksioneve”, lidhur me shitblerjen e Akkim Yapi Kimyasallari Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi dhe AKKIM EUROPE S.R.L.
14. Referuar kësaj Marrëveshje, blerësi ka rënë dakord të blejë aksione të paguara plotësisht, të zakonshme dhe të regjistruara të shoqërisë Akkim Turkey, që përfaqëson 86% të kapitalit aksionar të emetuar të shoqërisë nga Hazreti Akdemir; 14% të kapitalit aksionar të emetuar të shoqërisë, nga z. Ramazan Akdemir dhe të gjithë kapitalin aksionar të emetuar të AKKIM EUROPE S.R.L.
15. Pas implementimit të transaksionit të propozuar, shoqëria Sika AG do të ushtrojë kontroll të vetëm mbi të gjitha shoqëritë target, me 100% të aksioneve në secilën prej shoqërive target, në mënyrë direkte ose indirekte. Transaksioni i propozuar pritet të implementohet, pasi të jenë përmbushur kushtet paraprake të përcaktuara në Marrëveshje.
16. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërive Akkim Yapi Kimyasallari Sanayi Ve Ticaret Anonim Şirketi, Akfix Kimya Lojistik Hizmetleri Limited Şirketi, Akde Kimya Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi dhe AKKIM EUROPE S.R.L. nga shoqëria Sika AG, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

17. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i furnizimit me produkte (i) izoluese; (ii) ngjitës adezivë; (iii) shkumë poliuretani; (iv) produkte hidroizolomi dhe (v) aerosol, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
18. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërive Akkim Yapi Kimyasallari Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi dhe AKKIM EUROPE S.R.L. nga shoqëria Sika AG.
19. Shoqëritë target: Akkim Turkey është aktive [____] dhe AKKIM EUROPE është një shoqëri aktive [____].
20. Shoqëria blerëse, Sika AG zhvillon dhe prodhon, në veçanti, aditivë me bazë kimike për beton dhe llaçe, llaçe speciale, izolues dhe ngjitës adeziv, materiale për amortizim dhe përforcim, etj dhe ka [____].

21. Asnjëra nga palët në transaksion nuk kanë aktivitete prodhuese në Shqipëri. Nga një vlerësim i palëve njoftuese për tregun dhe shitjet e produkteve në Shqipëri, është konstatuar se aktivitetet e shitësit dhe targetave mbivendosen horizontalisht në një numër të kufizuar segmentesh produkti, por me pjesë të kombinuara tregu të ulëta dhe rritje të papërfillshme në Shqipëri. Transaksioni i propozuar nuk pritet të sjellë ndryshime të ndjeshme në strukturën e tregut në Shqipëri.
22. Nga sa më sipër konstatohet se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërive Akkim Yapı Kimyasalları Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi dhe AKKIM EUROPE S.R.L. nga shoqëria Sika AG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1285, Datë 10.04.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË INFOTELECOM - ALBSOLAR 1 SHPK NGA SHOQËRITË INFO-TELECOM SHPK DHE TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Denar BIBA	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.04.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Infotelecom - Albsolar 1 SHPK nga shoqëritë INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Infotelecom - Albsolar 1 SHPK nga shoqëritë INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Infotelecom - Albsolar 1 SHPK nga shoqëritë INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

2. Referuar dokumentit “Kontratë për Shitjen dhe Transferimin e Kuotës”, të nënshkruar më datë 05.03.2026, palët në marrëveshje janë:
3. **Pala blerëse: TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK (TID)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: marrja përsipër e hartimit të projekteve të ndryshme ndërtimore të fushave të ndryshme dhe të realizimit të ndërtimit në përgjithësi; ndërtim në fushën e turizmit, të infrastrukturës, qendrave të biznesit, aktivitet në blerjen, shitjen, qiradhënien e zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme, etj.
4. Referuar Formularit të njoftimit të përqendrimit si dhe QKB, shoqëria TID SHPK zotëron kuota në shoqëritë:
5. *Infotelecom – Albsolar 2 SHPK*, shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari në fushën e prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, siç është prodhimi i energjisë nga burime fotovoltaike, ruajtja dhe tregtimi i kësaj energjie brenda dhe jashtë vendit.
6. *AMB Construction SHPK*, shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: dhënie me qera e impianteve fotovoltaike, tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, impianteve/paneleve fotovoltaike, elektroshtëpiake, elektronike, sistemeve/impianteve termike, të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), sisteme për mirëmenaxhimin e energjisë, sisteme ndriçimi, të telekomunikacionit si dhe impianteve të tjera të ngjashme të destinuara për objekte civile dhe industriale, për sektorë të ndryshme, etj.
7. *HIDROBEGAJ SHPK*, shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: financim, projektim, ndërtim, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtje e hidrocentralit "BEGAJ", shitjen e energjisë së prodhuar dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës koncesionare.
8. *HYDROBORSH SHPK*, shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Fterre" dhe "Fterre 1" tek Autoriteti Kontraktues.
9. *The PLAZA Tirana SHPK*, shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: aktivitet në fushën e turizmit, hapja dhe manaxhimi i hoteleve, e godinave dhe ambienteve në të cilat ushtrohet aktivitet hotelier. Hapja dhe manaxhimi i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier, etj.
10. *BM Healthcare SHPK*, shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Investime dhe shërbime në fushën e mjekësisë dhe shëndetit. Organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese dhe kuruese dhe qendrave ambulatorie te diagnostikimit, ngritja dhe menaxhimi i spitaleve dhe klinikave private, etj.

11. **Pala shitëse: INFO-Telecom SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ofrimin e shërbimeve dhe çdo aktivitet në fushën e telekomunikacionit të përcaktuara në legjislacionin përkatës shqiptar. Përfaqësimi i shoqërive të ndryshme të huaja në territorin shqiptar. Aktivitete në blerjen, shitjen, qiradhënien e zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme, etj.
12. Referuar Formularit të njoftimit të përqendrimit si dhe QKB, shoqëria INFO-Telecom SHPK zotëron kuota në shoqëritë : *Infotelecom – Albsolar 2 SHPK; Infotelecom – Albsolar 4 SHPK; AMB Construction SHPK* dhe indirekt zotëron kuota në shoqëritë: *Solar Park Gjollce SHPK; DANI ENERGY 2023 SHPK; Infotelecom-Albsolar 3 SHPK; ENER TRADE SHPK, ETMT SHPK* të cilat operojnë në tregun e prodhimit të energjisë së rinovueshme; shoqërinë *TOP FRUITS SHPK*, aktive në grumbullimin, magazinimin, ruajtjen, eksportin fruta perime dhe importe të ndryshme, si dhe shoqërinë *Profesional Marketing Albania SHPK*, aktive në biznesin e ofrimit të shërbimeve të kontraktimit (Business Process Outsourcing) për të gjitha proceset, nën proceset, transaksionet, aktivitetet dhe të gjitha aktivitetet e tjera të kryera nga bizneset në industri të ndryshme, etj.
13. Nga sa më sipër, evidentohet se pala blerëse dhe shitëse zotërojnë së bashku kuota në disa nga shoqëritë e mësipërme.
14. **Shoqëria target: Infotelecom – Albsolar 1 SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari në fushën e prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme siç është prodhimi i energjisë nga burime fotovoltaike, ruajtja dhe tregtimi i kësaj energjie brenda dhe jashtë vendit. Sipas legjislacionit në fuqi, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të konsideruar të dobishëm apo të nevojshëm, për arritjen e objektivave të saj, i cili lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.
15. Shoqëria zotërohet tërësisht nga shoqëria INFO-Telecom SHPK.

II. Përqendrimi

16. Me datë 05.03.2026, pala shitëse, shoqëria INFO-Telecom SHPK dhe pala blerëse, shoqëria TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, kanë nënshkruar dokumentin “Kontratë për Shitjen dhe Transferimin e Kuotës”, në të cilën kanë rënë dakord që pala shitëse, INFO-Telecom SHPK, i shet dhe i transferon palës blerëse, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, pjesën takuese prej 50% (pesëdhjetë përqind) të kuotave të regjistruara të shoqërisë Infotelecom – Albsolar 1 SHPK.
17. Pas realizmit të transaksionit, struktura e ortakërisë së shoqërisë do të jetë: 50% të kuotës do të zotërohet nga INFO-Telecom SHPK dhe 50% të kuotës do të zotërohet nga TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

18. Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar ka sjellë për pasojë përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Infotelecom – Albsolar 1 SHPK nga shoqëritë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe INFO-Telecom SHPK, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

19. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si edhe aktivitetit të palëve pjesëmarrëse në transaksion, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të energjisë elektrike dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
20. Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Infotelecom – Albsolar 1 SHPK nga shoqëritë TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK dhe INFO-Telecom SHPK.
21. Shoqëria TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK është një shoqëri me objekt aktiviteti marrjen përsipër të hartimit të projekteve të ndryshme ndërtimore të fushave të ndryshme dhe të realizimit të ndërtimit në përgjithësi; ndërtim në fushën e turizmit, të infrastrukturës, qendrave të biznesit; etj, ndërkohë që shoqëria target Infotelecom – Albsolar 1 SHPK pritet të realizojë ndërtimin e një parku fotovoltaik, në rrethin e Fierit, për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet solare. Projekti është ende në fazën e projektimit dhe pajisjes më lejet përkatëse.
22. Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim konglomerat pasi palët pjesëmarrëse në transaksion operojnë në tregje të ndryshme.
23. Përqendrimi nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, nuk sjell ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun përkatës të produktit.
24. Nga vlerësimi i dokumentacionit u konstatua se, ortakët kontrollues të shoqërisë target zotërojnë kuota në shoqëri të tjera, me objekt aktiviteti në tregun e prodhimit të energjisë elektrike, por vetëm njëra prej tyre, shoqëria HYDROBORSH SHPK, është aktive në tregun përkatës të produktit duke zënë një pjesë shumë të vogël në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.
25. Ndërkohë ERE ka licensuar shoqërinë Infotelecom – Albsolar 4 SHPK për prodhimin e energjisë solare, e cila ende nuk ka filluar prodhimin e energjisë.
26. Transaksioni i njoftuar, aktualisht nuk krijon shqetësime për konkurrencën për shkak të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në treg, por palët pjesëmarrëse rezultojnë të kenë disa

projekte zhvillimore në treg, duke ndikuar në rritjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe në stabilitetin e sistemit energjetik në vend.

27. Gjithsesi, tregu i prodhimit dhe shitjes së energjisë elektrike është një treg i rregulluar ku mekanizmi konkurrues i çmimit përcaktohet nga rregullatori. Ky transaksion nuk sjell shqetësime për konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar për përfitimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Infotelecom - Albsolar 1 SHPK nga shoqëritë INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1286, Datë 23.04.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË TV KABLLOR SHIJAKU SHPK NGA SHOQËRIA ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.04.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë TV Kabllor Shijaku SHPK nga shoqëria Albanian Satellite Communications SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përftimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë TV Kabllor Shijaku SHPK nga shoqëria Albanian Satellite Communications SHPK”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e realizuar mbi përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë TV Kabllor Shijaku SHPK nga shoqëria Albanian Satellite Communications SHPK.
2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:
3. **Blerësi: Albanian Satellite Communications SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie: shërbime në fushën

e telekomunikacionit, transmetimit satelitor, transmetimit të të dhënave, figurë, video, kërkime, konsultime, projekte, organizime, shpërndarje e produkteve të teknologjisë së lartë, shitjen dhe zbatimin e studimeve të ndryshme pas miratimit dhe në bazë të lejeve nga institucionet përkatëse; investimet në infrastrukturën e transmetimeve të të dhënave, investime direkte ose përdorim i kapaciteteve të tregut etj; investimin e kapitaleve të shoqërive dhe financime të tjera për blerjen e pasurive të patundshme dhe në vazhdim të aktiviteteve për arritjen e objektit të shoqërisë; zhvillimin e projekteve dhe rindërtimin e ndërmarrjeve industriale, pas dhe në bazë të lejeve të miratuara për shoqërinë nga institucionet përkatëse.

4. **Shitësi: Sh. B.** është individ, shtetas shqiptar.
5. **Target: TV Kabllor Shijaku SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti veprimtari televizioni kabllor. Shoqëria TV Kabllor Shijaku SHPK është subjekt i autorizuar nga AMA si OSHMA për përsëritjen e programit audioviziv dhe me zonë licencimi Qyteti i Shijakut.

II.Përqendrimi

6. Më datë [...], shitësi z. Shkëlqim Bërhami (znj. H. Bërhami dhënëse e pëlqimit) dhe blerësi Albanian Satellite Communications SHPK kanë nënshkruar dokumentin “Kontrata e Shitjes së Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë TV Kabllor Shijaku SHPK”.
7. Blerësi Albanian Satellite Communications SHPK pranon të blejë kuotat e shitësit që përfaqësojnë 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë TV Kabllor Shijaku SHPK.
8. Më nënshkrimin e kontratës dhe me kryerjen e pagesës së plotë të shitjes së kuotave, blerësi shoqëria Albanian Satellite Communications SHPK bëhet zotëruesi i 100% të gjithë kapitalit dhe përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë target.
9. Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë TV Kabllor Shijaku SHPK nga shoqëria Albanian Satellite Communications SHPK, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III.Analiza e konkurrencës

10. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ritransmetuesve/përsëritës të programeve audiovizive mbështetur në rrjetet kabllore dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Shijakut dhe rrethinat.
11. Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë TV Kabllor Shijaku SHPK nga shoqëria Albanian Satellite Communications SHPK.

12. Nga analiza u konstatua se transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim konglomerat, sepse palët ushtrojnë aktivitet në tregje të ndryshme dhe konkretisht: shoqëria Albanian Satellite Communications SHPK ka si objekt të veprimtarisë shërbime në fushën e telekomunikacionit, transmetimit satelitor, transmetimit të të dhënave, figurë, video, kërkime, konsultime, projekte, organizime, shpërndarje e produkteve të teknologjisë së lartë, etj, ndërsa shoqëria TV Kabllor Shijaku SHPK është aktive në ritransmetimin/përsëritjen e programeve audiovizive mbështetur në rrjetet kabllore.
13. Realizimi i përqendrimit përmes kalimit nga kontroll i përbashkët në kontroll të vetëm nga shoqëria Albanian Satellite Communications SHPK mbi shoqërinë TV Kabllor Shijaku SHPK, pritet të sjellë përfitime të drejtpërdrejta dhe të matshme për konsumatorin si: rënie e çmimit të produkteve/shërbimeve, rritja e cilësisë së produkteve/shërbimeve, inovacion teknologjik etj.
14. Transaksioni i realizuar nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjell ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun përkatës. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë TV Kabllor Shijaku SHPK nga shoqëria Albanian Satellite Communications SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr.1287, Datë 23.04.2026

**“KËRKESË PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT NGA ANA E NDËRMARRJES
TIRANA ADMINISTRIM SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.04.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Kërkesë për sigurimin e informacionit nga ana e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 33 pika 2 dhe pika 3 dhe neni 73 pika 1, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1145, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë gjëmbajtjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK”, ka vendosur:
- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.

- II. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim.
- III. Gjykitjen e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK në masën 6% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në 442,632 Lekë.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK që brenda 90 ditëve të rishikojë dispozitat e kontratave të lidhura me operatorët që ofrojnë shërbimin e internetit, të cilat mos të jenë në kundërshtim me nenin 9, pika 2, germa (c) dhe (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.
- V. Detyrimin e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK, që në rezidencat e administruara prej saj, të lejojë aksesin dhe për ndërmarrjet e tjera të cilat e kërkojnë këtë akses për të ofruar shërbimin.
- VI. Detyrimin e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK për të mos abuzuar me pozitën dominuese, veçanërisht:
- a) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
 - b) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
 - c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - d) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
- VII. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.
- VIII. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Tirana Administrim SHPK, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të Ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.
2. Në zbatim të nenit 33, të Ligjit nr. 9121/2003, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Vendimit nr. 1145/2024, me shkresën nr. 97 prot., datë 29.01.2026, me objekt “Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1145, datë 27.12.2024”, i është drejtuar ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK duke kërkuar informacion

lidhur me zbatimin e pikës (IV), (V) dhe (VI) të VKK nr. 1145, datë 27.12.2024, me afat për kthim - përgjigje brenda datës 23.01.2026. Ndërmarrja Tirana Administrim SHPK nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.

3. Në vijim, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 97/1 prot., datë 17.03.2026, me objekt “Rikujtesë mbi kërkesën për informacion të AK nr. 97 prot., datë 29.01.2026”, i është drejtuar sërish ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK duke i kërkuar vënien në dispozicion të të dhënave të mësipërme brenda datës 27.03.2026. Edhe ndaj kësaj kërkesë, ndërmarrja nuk ka paraqitur asnjë përgjigje.
4. Gjithashtu, me email-in e datës 30.03.2026 (protokolluar me nr. 97/2 prot., datë 30.03.2026), me objekt “Kërkesë për dhënie informacioni dhe rikujtesë mbi detyrimet ligjore”, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës i është drejtuar përsëri ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK, duke kërkuar sigurimin e informacionit të kërkuar brenda datës 03.04.2026. Edhe kësaj here, ndërmarrja nuk i është përgjigjur kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës.
5. Komisioni i Konkurrencës vlerëson se informacioni i kërkuar është i domosdoshëm për vijimin e procedurës, pasi lidhet drejtpërdrejt me verifikimin e zbatimit të vendimit nga ana e ndërmarrjes, ndaj së cilës është vendosur monitorimi për një periudhë njëvjeçare.
6. Në zbatim të nenit 33, pika 2 dhe pika 3 të Ligjit nr. 9121/2003, kur ndërmarrja nuk jep të dhënat e kërkuara, brenda periudhës së caktuar në kërkesën e Sekretariatit, Komisioni, kur e vlerëson të nevojshme, i kërkon të dhënat nëpërmjet një vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. T’i kërkojë ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin lidhur me zbatimin e pikës (IV), (V) dhe (VI) të Vendimit nr. 1145, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë gjobitjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK”.

- II. Informacioni i përcaktuar në pikën I, duhet të dorëzohet brenda afatit 15 ditor nga dita që ky vendim është njoftuar.
- III. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në dispozitivin I dhe II të këtij vendimi, ndërmarrja Tirana Administrim SHPK ndëshkohet me gjobë në masën deri në 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1288, Datë 23.04.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË EVERLLENCE MUSCAT LLC NGA SHOQËRIA EVERLLENCE SE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.04.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Everllence Muscat LLC nga shoqëria Everllence SE.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit vetëm të shoqërisë Everllence Muscat LLC nga shoqëria Everllence SE”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Everllence Muscat LLC nga shoqëria Everllence SE.
2. Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, nënshkruar më datë [_____], palët në marrëveshje janë:

3. **Blerësi: Everllence SE** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: zhvillimi, projektimi, prodhimi, shitja dhe shërbimi i makinerive dhe pajisjeve të të gjitha llojeve, në veçanti motorëve me naftë të të gjitha llojeve dhe për të gjitha aplikimet, duke përfshirë motorët detarë dhe motorët për instalime stacionare, dhe turbomakineritë dhe kompresorët, si dhe ofrimi i të gjitha shërbimeve të lidhura, duke përfshirë licencimin.
4. Everllence SE është një filial i zotëruar në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Volkswagen Group. Grupi Volkswagen është aktiv në tregun ndërkombëtar kryesisht në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.
5. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.
6. *Porsche Leasing SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.
7. *Porsche Albania SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti; shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj.
8. Shoqëria Everllence SE zotëron X% të aksioneve në shoqërinë target.
9. **Shitësi: Oman International Petroleum and Energy Services Co. LLC** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Omanit (Sulltanati i Omanit). Shoqëria Oman International Petroleum and Energy Services Co. LLC zotëron X% të aksioneve në shoqërinë target.
10. **Shoqëria target: Everllence Muscat LLC** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe ushtron aktivitetin e saj në Oman si një filial lokal i shoqërisë Everllence SE dhe shërbën si qendra rajonale e saj për menaxhimin e projekteve, shitjet dhe mbështetjen teknike, si dhe funksionon si qendra koordinuese për projektet detare dhe të shërbimeve të gjenerimit të energjisë. Everllence Muscat LLC ofron shërbime pas shitjes, të tilla si inxhinieri, mbështetje në terren dhe zgjidhje mirëmbajtje për sistemet e shtytjes detare dhe termocentralet e gjenerimit të energjisë.

11. [_____].

II. Përqendrimi

12. Më datë [_____], ndërmjet Everllence SE (blerësi) dhe Oman International Petroleum and Energy Services Co. LLC (shitësi) është nënshkruar “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, lidhur me shitblerjen e aksioneve në Everllence Muscat LLC.
13. Referuar kësaj Marrëveshje, blerësi dhe shitësi janë aksionarë të shoqërisë target, ku blerësi aktualisht zotëron X% të kapitalit aksionar dhe shitësi zotëron X% të kapitalit aksionar. Përpara implementimit të transaksionit shoqëria target kontrollohet bashkërisht nga shoqëritë Everllence SE dhe Oman International Petroleum and Energy Services Co. LLC.
14. Blerësi synon të blejë nga shitësi aksionet e shitjes, duke zotëruar X% të kapitalit dhe përfitimn e kontrollit të vetëm të shoqërisë target, Everllence Muscat LLC nga blerësi Everllence SE, dhe si rrjedhojë në mënyrë indirekte kontrollin nga Grupi VW.
15. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitimn e kontrollit të vetëm të shoqërisë Everllence Muscat LLC nga shoqëria Everllence SE, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

16. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu për ofrimin e shërbimeve pas shitjes (si riparimi dhe mirëmbajtja) dhe pjesë këmbimi për makineritë turbo, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
17. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitimn e kontrollit të vetëm të shoqërisë Everllence Muscat LLC nga shoqëria Everllence SE.
18. Shoqëria Everllence SE është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit gjerman me objekt aktiviteti në fushën e inxhinierisë së specializuar në zgjidhje për shtytjen, dekarbonizimin dhe efikasitetin për industrinë detare, sektorin e energjisë dhe aplikimet industriale dhe pjesë e Grupit Volkswagen.
19. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, respektivisht në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, si dhe në tregun e qirasë financiare, agjent në sigurime.
20. Shoqëria target Everllence Muscat ofron shërbime pas shitjes të tilla si inxhinieri, mbështetje në terren dhe zgjidhje mirëmbajtje për sistemet e shtytjes detare dhe termocentralet e gjenerimit të energjisë. Target nuk është i pranishëm dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri.

21. Duke qenë se Blerësi dhe Target nuk janë të pranishëm në Shqipëri në tregun përkatës, përqendrimi nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjell ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Everllence Muscat LLC nga shoqëria Everllence SE.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1289, Datë 20.05.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA NGA SHOQËRITË AUCTOR HOLDING, A.S. DHE SPV SECOND A.S., NËPËRMJET SHOQËRISË DD RAIL PROPERTIES A.S.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA nga shoqëritë Auctor Holding, a.s. dhe SPV Second a.s., nëpërmjet shoqërisë DD Rail Properties a.s.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA nga shoqëritë Auctor Holding, a.s. dhe SPV Second a.s., nëpërmjet shoqërisë DD Rail Properties a.s.”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA nga shoqëritë Auctor Holding, a.s. dhe SPV Second a.s.

2. Referuar dokumentit “Marrëveshje paraprake për blerjen e aksioneve”, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: DD Rail Properties a.s.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Republikës Çeke, me objekt veprimtarie menaxhimin e pronës, qiradhënien e pasurive të paluajtshme, apartamenteve dhe hapësirave komerciale. DD Rail Properties a.s. është një shoqëri me qëllim të veçantë SPV, e cila zotërohet xx% nga Auctor Holding, a.s. (përmes Auctor Alfa, a.s.) dhe xx% nga SPV Second a.s.
4. **Auctor Holding, a.s.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Republikës Çeke, me objekt veprimtarie menaxhimin e pronës. Auctor Holding, a.s. zotëron plotësisht shoqërinë Auctor Alfa, a.s., një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Republikës Çeke, me objekt veprimtarie menaxhimin e aseteve të veta. Shoqëria nuk është prezente dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.
5. **SPV Second a.s.** ka si objekt veprimtarie menaxhimin e pronës, qiraja e pasurive të paluajtshme, apartamenteve dhe ambienteve jo-rezidenciale. SPV Second zotërohet nga z. J. S., i cili është aktiv përmes grupit CE Industries (grupi JS) në tregjet evropiane në sektorët e transportit hekurudhor, riciklimit të lëndëve të para, energjisë si dhe produkte ushqimore dhe farmaceutike. Grupi JS ka realizuar të ardhura në Shqipëri përmes shitjes së kimikateve.
6. **Shitësit: Cres Fundacja Rodzinna, Marsel Fundacja Rodzinna dhe Neuvic Fundacja Rodzinna**, fondacione familjare që ekzistojnë në bazë të ligjeve të Republikës së Polonisë.
7. **Target: OT LOGISTICS SPÓLKA AKCYJNA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Polonisë, me objekt veprimtarie: nxjerrja e zhavorrit, rërës, argjilës dhe kaolinit; prodhimi i produkteve të formuara në të ftohtë, i strukturave metalike dhe pjesëve të tyre, i pajisjeve ngritëse dhe të ngarkim – shkarkimit, i anijeve turistike dhe sportive; punime ndërtimore lidhur me ngritjen e ndërtesave rezidenciale dhe jo-rezidenciale; transport rrugor, hekurudhor, mallrash, pasagjerësh etj. Target nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri.
8. Sipas deklaratës së palës njoftuese, përpara zbatimit të transaksionit të propozuar, asnjë entitet nuk ushtron kontroll mbi shoqërinë target.

II. Përqendrimi

9. Më datë [_____], ndërmjet shoqërisë DD Rail Properties a.s. (blerësi) dhe Cres Fundacja Rodzinna, Marsel Fundacja Rodzinna dhe Neuvic Fundacja Rodzinna (shitësit) është nënshkruar “Marrëveshje paraprake për blerjen e aksioneve”.
10. Referuar kësaj Marrëveshje, blerësi synon të blejë dhe shitësit synojnë të shesin aksionet në shoqërinë target, që përfaqësojnë afërsisht 49.99% të kapitalit aksionar dhe të të drejtave të votës në shoqërinë target.

11. Pas transaksionit të propozuar, shoqëria target OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA do të zotërohet: Auctor Holding, a.s. dhe SPV Second a.s. (përmes DD Rail Properties a.s.) 49.99%, Shitësit [....].
12. Sipas statutit të shoqërisë target organet drejtuese të shoqërisë janë: 1) Bordi Drejtues; 2) Bordi Mbikëqyrës; 3) Asambleja e Përgjithshme. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme. Referuar formularit të thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit dhe shkresës nr. 56/5 prot., i AK, datë 21.04.2026, blerësit përmes DD Rail Properties a.s. pritët të marrin të drejtën për të nominuar katër anëtarë nga shtatë anëtarët e Bordit Mbikëqyrës dhe vendimet si miratimi i buxhetit vjetor, plani i biznesit dhe investimet e rëndësishme merren nga Bordi Mbikëqyrës me shumicë të thjeshtë. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë merr vendime me shumicë të thjeshtë votash për ndryshimin e statutit të shoqërisë; rritja ose zvogëlimi i kapitalit aksionar; ndryshimi i aktivitetit të biznesit të shoqërisë etj.
13. Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” pika 52 përcaktohet se zotërimi i një pakice të aksioneve mund të çojë në kontroll de facto kur aksionari që zotëron pakicën e aksioneve mund të arrijë shumicën në asambletë e aksionarëve, duke patur parasysh nivelin e aksioneve të tij dhe pjesëmarrjen e aksionarëve në mbledhjet e mëparshme të asamblesë. Kjo vlen edhe në rastet kur dy ose më shumë ndërmarrje fitojnë aksione të aksionarëve që zotërojnë pakicën e aksioneve dhe veprojnë së bashku në ushtrimin e të drejtave të tyre të votës, në mënyrë të tillë që aksionet e tyre të kombinuara të arrijnë në një shumicë de facto të të drejtave të votës në asambletë e aksionarëve (siç parashikohet në Udhëzim, pika 66).
14. Bazuar në dokumentacionin e depozituar, edhe pse Auctor Holding, a.s. dhe SPV Second a.s. (përmes DD Rail Properties a.s.) nuk zotërojnë shumicën absolute të kapitalit, struktura aksionare dhe praktika e pjesëmarrjes në asamble mundësojnë ushtrimin e ndikimit vendimtar mbi aktivitetin e Shoqërisë dhe si rrjedhojë, shoqëritë blerëse përmes DD Rail Properties a.s. do të ushtrojnë kontroll të përbashkët de facto mbi shoqërinë target OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA.
15. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA nga shoqëritë Auctor Holding, a.s. dhe SPV Second a.s., nëpërmjet shoqërisë DD Rail Properties a.s., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”. Si i tillë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

16. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i operacioneve portuale dhe shërbimeve të transportit, shpërndarjes dhe

logjistikës, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

17. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA nga shoqëritë Auctor Holding, a.s. dhe SPV Second a.s., nëpërmjet DD Rail Properties a.s.
18. Auctor Holding dhe OT Logistics nuk janë prezente dhe nuk kanë realizuar të ardhura në Shqipëri.
19. SPV Second është pjesë e grupit CE Industries (e zotëruar nga z. JS), i cili vepron në transport hekurudhor, energji, riciklim dhe tregti, por nuk është aktiv në operacionet portuale. Asnjë nga shoqëritë e grupit nuk ka prezencë juridike në Shqipëri, por kanë realizuar të ardhura përmes shitjes së kimikateve.
20. Nga sa më sipër, transaksioni i propozuar nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjell ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA nga shoqëritë Auctor Holding, a.s. dhe SPV Second a.s., nëpërmjet DD Rail Properties a.s.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1290, Datë 20.05.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË VALAMAR TALE 2 SHPK NGA SHOQËRIA BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit për përfitim e kontrollit të shoqërisë Valamar Tale 2 SHPK nga shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të shoqërisë Valamar Tale 2 SHPK nga shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Referuar dokumentit “Kontratë shitje kuote kapitali”, nënshkruar më datë 25 mars 2026, palët në transaksion janë:
2. **Pala blerëse: Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila ka për objekt aktiviteti: (i) investimi në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimin në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), si dhe (ii) ofrimi i shërbimeve të

konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose nga të tretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softuares etj), në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, etj.

3. Ortaku i vetëm i shoqërisë është Z. Samir Mane me 100% të kuotave të kapitalit.
4. Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK operon në një numër të madh industrish si në Sektorin Bankar, në Zhvillimin e Pasurive të Paluajtshme, në Administrim Qendrash Tregtare, në Industrinë Retail, Logjistike Transport, etj, në Shqipëri, Austri, Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Bosnje-Hercegovinë, Mal i Zi, Holandë, Zvicër, SHBA dhe Kanada.
5. **Pala shitëse: Kupa SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: kryerjen e punimeve të ndryshme ndërtimore, objekte social kulturore e banimi, projektimin dhe zbatimin e tyre, rrugë, kanalizime, ura e vepra arti, prodhimin për përdorimin e shitjen e materialeve inerte, hapjen e linjave të inerteve, rikonstruksione të çdo lloji. Punime ndërtimi banesa dhe shërbimi në ekonomi. Tregtim me pakicë e shumicë, import, eksport të materialeve elektrike, hidraulike, dhe ndërtimi, etj.
6. Ortaku i vetëm i shoqërisë është z. Shkëlqim Kupa me 100% të kuotave të kapitalit.
7. **Target: Valamar Tale 2 SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Shoqëria ka objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuar më poshtë: a) Zhvillimin, projektimin dhe ndërtimin e objekteve civile dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë; b) Shitja e objekteve/njësive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira; c) Veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt dhe indirekt të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar; d) Shfrytëzimin e zonave malore apo bregdetare/plazheve për qëllime turistike, duke administruar, dhënë me qira, ndërtuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argëtimit, bar, restorante në zona turistike etj.; e) Administrimi i bashkëpronësisë në ndërtesa, në resorte apo struktura turistike dhe në komplekse rezidenciale; f) Ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave etj; g) Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të Shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe mos të alterojnë objektin parësor të veprimtarisë së Shoqërisë. Shoqëria target nuk zotëron kuota në shoqëri të tjera.
8. Ortaku i vetëm i shoqërisë është shoqëria KUPA SHPK me 100% të kuotave të kapitalit.
9. Referuar vendimeve të marra nga KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT, në mbledhjen e datës 23.07.2025, u konstatua dhënien e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Resort Turistik “Valamar Tale”, me vendndodhje në Tale, Bashkia Lezhë”, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Valamar Tale 2” sh.p.k dhe “Valamar Tale Hotel” sh.p.k.

II. Përqendrimi

10. Më datë [...], shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK në cilësinë e blerësit dhe shoqëria KUPA SHPK në cilësinë e shitësit kanë nënshkruar dokumentin “Kontratë shitje kuotë kapitali”.
11. Objekti i kontratës është shitja dhe transferimi i Kuotës dhe Titullit të pronësisë të shoqërisë Valamar Tale 2 SHPK nga shitësi tek blerësi, në përputhje me parashikimet e kontratës.
12. Në përmbushje të termave të kontratës, blerësi, shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, do të jetë zotëruesi i vetëm i kuotës së kapitalit të shoqërisë Valamar Tale 2 SHPK.
13. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Valamar Tale 2 SHPK nga shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, transaksion, i cili është në përputhje me nenet 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

14. Mbështetur në aktivitetin e palëve pjesëmarrëse në transaksion dhe referuar fazës në të cilën ndodhet aktiviteti i targetit, është vlerësuar se fillimisht ky transaksion do të prekë tregun i zhvillimit të projekteve të ndërtimit për shitje, i cili, sipas klasifikimit NVE Rev.2 të INSTAT, përfshihet në klasën 41.10 “Hartimi i projekteve të ndërtimit”. Sipas këtij klasifikimi, kjo klasë përfshin zhvillimin e projekteve për ndërtesa rezidenciale dhe jo-rezidenciale, duke bashkuar mjetet financiare, teknike dhe fizike për realizimin e projekteve të ndërtesave që synohen për shitje.
15. Në mënyrë të lidhur dhe pas përfundimit të fazës së projektimit, tregu i prekur nga përqendrimi do të lidhet me klasën 41.20 “Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale dhe jo rezidenciale”, e cila mbulon ndërtimin e plotë të ndërtesave rezidenciale dhe jo-rezidenciale, për llogari të vet, për shitje ose sipas kontratës.
16. Referuar lejes ndërtimore, pritet që struktura do të ketë funksionin e resorit turistik dhe menaxhimi i tij do të jetë një aktivitet ekonomik në një fazë më të vonë.
17. Për sa më sipër dhe referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës do të konsiderohet tregu i projektimit, ndërtimit dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme dhe tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
18. Blerësi, shoqëria Balfin- Balkan Finance Investment Group SHPK, ushtron veprimtari në disa sektorë ekonomikë, përfshirë sektorin bankar, zhvillimin e pasurive të paluajtshme, administrimin e qendrave tregtare, tregtinë me pakicë, si edhe logistikën dhe transportin.
19. Në tregun e zhvillimit, projektimit dhe ndërtimit të objekteve civile dhe shitja e objekteve/njësive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira, Z. Samir Mane direkt ose nëpërmjet shoqërive të kontrolluar prej tij, zotëron kuota në shoqëritë : ACREM (Albanian Commercial Real

Estate Management), Balfin Asset Management, Balfin Real Estate, Balfin Hospitality, Belvedere Korca, Green Coast, Balfin Construction (ish Mane TCI), Balfin Development, Rolling Hills by the Lake, Tirana Logistic Park, Vala Mar 2.

20. Targeti, shoqëria Valamar Tale 2 SHPK, ndodhet aktualisht në fazën e zhvillimit të projektit dhe nuk ka ende aktivitet tregtar të konsoliduar në treg. Për këtë arsye, pjesa e tregut e targetit vlerësohet 0% në momentin e njoftimit. Shoqëria target nuk ka filiale në pronësi dhe nuk zotëron pjesëmarrje në kapitalin e asnjë shoqërie tjetër.
21. Mbi bazën e të dhënave publike të disponueshme për vitin 2023, dhe për qëllime të vlerësimit të strukturës së tregut përkatës të produktit, tre konkurrentët më të afërt të shoqërisë Balfin SHPK, me xhiron më të lartë nga lista orientuese e operatorëve të përmendur në sektor, rezultojnë të jenë GENER 2 SHPK, SALILLARI SHPK dhe FUSHA SHPK.
22. Mbështetur në të dhënat e INSTAT për madhësinë e tregut, mbi vlerën e përafërt të lejeve të ndërtimit për ndërtesa dhe vepra inxhinierike civile, si dhe xhirot vjetore të operatorëve kryesor në treg, të marrë nga të dhënat financiare publike të disponueshme pranë QKB, rezulton se shoqëria GENER 2 SHPK zë xx% të tregut, shoqëria SALILLARI SHPK zë xx%, shoqëria FUSHA SHPK zë xx% dhe shoqëria Balfin zë xx%.
23. Transaksioni i njoftuar krijon mbivendosje horizontale të palëve në tregun përkatës të produktit, por pjesa e kombinuar e blerësit dhe targetit së bashku do të mbetet e pandryshuar sepse shoqëria target ndodhet aktualisht në fazën e zhvillimit të projektit dhe nuk ka ende aktivitet tregtar të konsoliduar në treg. Transaksioni nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, nuk cenon konkurrencën efektive ndërmjet operatorëve ekzistues dhe nuk sjell ndryshime thelbësore në strukturën e tregut, përtej ndryshimit të kontrollit mbi shoqërinë Target.
24. Ky transaksioni nuk pritet të ketë efekte negative në konkurrencën në tregun shqiptar të ndërtimit dhe zhvillimit të pasurive të paluajtshme, duke marrë në konsideratë natyrën e tregut përkatës, si edhe profilin dhe përvojën e Balfin si Blerës. Përfshirja e Balfin pritet të përmirësojë mënyrën e operimit të shoqërisë, pa ndikuar negativisht në ekuilibrat konkurrues të tregut.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin për përfitim e kontrollit të shoqërisë Valamar Tale 2 SHPK nga shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1291, Datë 20.05.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIA GAS TECH SHA NGA SHOQËRIA JONUZ KASTRATI SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIA GAS TECH SHA nga shoqëria JONUZ KASTRATI SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIA GAS TECH SHA nga shoqëria JONUZ KASTRATI SHPK”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e realizuar për përfutimin e kontrollit të shoqërisë ALBANIA GAS TECH SHA nga shoqëria JONUZ KASTRATI SHPK.
2. Referuar dokumenteve “Kontratë Dhurimi Pasuri e Luajtshme (Aksione)”, “Kontratë Shkëmbimi Aksionesh”, “Marrëveshje për Transferimin e Aksioneve” dhe “Kontratë Shkëmbimi Kuotash”, palët në marrëveshje janë:

3. **Blerësi: JONUZ KASTRATI SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie funksionimin si një shoqëri holding, me pjesëmarrje direkte ose indirekte në kapitalin tregtar të shoqërive të tjera tregtare, vendase ose të huaja. Shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion të ligjshëm tregtar e financiar, duke përfshirë por pa u kufizuar në të drejtën e saj për të investuar në instrumente financiare, tituj pjesëmarrje në kapitale, tituj borxhi, aksione e kuota dhe /ose fonde investimesh.
4. Referuar organigramës së depozituar nga pala njoftuese, JONUZ KASTRATI SHPK zotëron kuota / aksione në shoqëri që operojnë në tregun e prodhimit dhe shitjes së energjisë, në tregun e ndërtimit, në tregun e automjeteve dhe infrastrukturës rrugore dhe në tregun e infrastrukturës së depozitimit dhe shitjes së hidrokarbureve.
5. Sipas statutit, shoqëria JONUZ KASTRATI SHPK kontrollohet nga shoqëria KASTRATI SHPK.
6. Shoqëria *KASTRATI SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila organizohet dhe funksionon si një shoqëri holding, me pjesëmarrje direkte ose indirekte në kapitalin tregtar të shoqërive të tjera tregtare, vendase ose të huaja. Në këtë aspekt shoqëria mund të koordinojë, organizojë, kontrollojë dhe menaxhojë në cilësinë e shoqërisë holding, në aspektin ligjor, teknik, administrativ, financiar dhe strukturor të gjitha shoqëritë e grupit dhe / ose shoqëri të tjera që veprojnë në industrinë e ndryshme, duke krijuar për këtë qëllim borde të centralizuara menaxhimi dhe administrimi, si dhe duke ofruar shërbime të këshillimit financiar, teknik, zhvillimit strategjik, zhvillimit të biznesit etj.
7. KASTRATI SHPK zotërohet plotësisht nga z. Shefqet Kastrati, individ, i cili vetë apo nëpërmjet shoqërive të tjera, zotëron kuota / aksione në shoqëritë që operojnë në tregun e infrastrukturës së transportit ajror, në tregun e arsimit, në tregun e shitjes dhe administrimit të pasurive të paluajtshme, në tregun e prodhimit të energjisë elektrike dhe në tregun e sigurimeve.
8. **Shitësit: Z. Shefit Kastrati**, individ.
9. **Target: ALBANIA GAS TECH SHA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti krijimin, instalimin dhe vënien në shfrytëzim të impianteve, stacioneve, reparteve, linjave për tregtimin e hidrokarbureve brenda e jashtë vendit, import-eksport dhe tregti me shumicë e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikantë, transporti kombëtar e ndërkombëtar i tyre, import-eksport dhe tregti me shumicë e pakicë të teknologjisë dhe pjesëve të këmbimit për ushtrimin e veprimtarisë hidrokarbure, të automjeteve të transportit hidrokarbur, të kokave dhe cisternave bote për to dhe për depozita stacionare të bombolave me ose pa mbushje gazi si dhe dhënien e asistencës teknike për to, ndërtimin dhe vënien në përdorim të depove hidrokarbure, rezervuarëve të linjave dhe pikave të shitjes së tyre sipas projektit teknologjik, import-eksport dhe tregti me shumicë e pakicë të

artikujve industrial, bujqësore, blegtorale, ushqimore, ndërtimore, elektroshtëpiake, audiovizive, elektrike, të makinerive për ndërtim, ndërtimin e çdo godine, qendra biznesi, hotele, bar-restorante, magazina, parking, komplekse turistike, depo stacionare për karburante e nënprodukteve të tyre, ngritjen dhe vënien në shfrytëzim të poligoneve të ndërtimit për prodhimin e materialeve inerte të betoneve etj.

10. ALBANIA GAS TECH SHA përpara transaksionit zotërohej 50% nga KASTRATI ENERGY TRADE SHA dhe 50% nga z. Shefit Kastrati.

II. Përqendrimi

11. Më datë [...], është nënshkruar “Kontratë Dhurimi Pasuri e Luajtshme (Aksione)”, ndërmjet z. Shefit Kastrati (dhuruesi) dhe z. Shefqet Kastrati, z. Selami Kastrati, z. Haredin Kastrati dhe z. Bilbil Kastrati (pranuesit e dhurimit). Referuar kësaj kontrate, dhuruesi, i cili zotëronte 50% të kuotave në shoqërinë target ALBANIA GAS TECH SHA, ka dhuruar 40% të aksioneve tek pranuesit e dhurimit.
12. Më datë [...] është nënshkruar “Kontratë Shkëmbimi Aksionesh” ndërmjet z. Shefqet Kastrati, znj. Nazlije Kastrati (bashkëshortja e z. Shefqet Kastrati), shoqërisë ALBANIA GAS TECH SHA në cilësinë e Shkëmbyesit të Parë dhe shoqërisë KASTRATI SHPK në cilësinë e Shkëmbyesit të Dytë. Referuar kësaj marrëveshje, z. Shefqet Kastrati i ka transferuar shoqërisë KASTRATI SHPK 32.5% të aksioneve të dhuruara më parë nga z. Shefit Kastrati.
13. Më datë [...] është nënshkruar “Marrëveshje për Transferimin e Aksioneve”, ndërmjet shoqërisë JONUZ KASTRATI SHPK, në cilësinë e blerësit, dhe shoqërisë KASTRATI ENERGY TRADE SHA, në cilësinë e shitësit. Referuar kësaj marrëveshje, palët kanë rënë dakord të transferojnë të gjithë aktivitetin holding dhe financiar të shoqërisë KASTRATI SHPK tek shoqëria JONUZ KASTRATI SHPK.
14. Më datë [...] është nënshkruar “Kontratë Shkëmbimi Kuotash” ndërmjet shoqërisë KASTRATI SHPK, z. Shefqet Kastrati, z. Shefit Kastrati, z. Selam Kastrati, z. Haredin Kastrati, z. Bilbil Kastrati dhe shoqërisë target ALBANIA GAS TECH SHA, në cilësinë e Shkëmbyesit të Parë, dhe shoqërisë JONUZ KASTRATI SHPK, në cilësinë e Shkëmbyesit të Dytë. Referuar kësaj marrëveshje, aksionet e zotëruara nga KASTRATI SHPK, z. Shefit Kastrati, z. Bilbil Kastrati, z. Selam Kastrati dhe z. Haredin Kastrati janë shkëmbyer me aksione në shoqërinë JONUZ KASTRATI SHPK.
15. Në përfundim të transaksioneve, struktura e ortakërisë së shoqërisë JONUZ KASTRATI SHPK do të përbëhet nga KASTRATI SHPK në masën 65%, z. Shefit Kastrati në masën 20%, z. Bilbil Kastrati në masën 5%, z. Haredin Kastrati në masën 5% dhe z. Selam Kastrati në masën nga 5%.
16. Në Statutin e shoqërisë JONUZ KASTRATI SHPK të datës 06.01.2025, është përcaktuar se kompetencat e Asamblesë së Ortakëve do të ushtrohen nga Ortaku i Vetëm. Në rastin e marrjes

së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë. Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në fjalinë më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

17. Referuar marrëveshjeve të mësipërme dhe statutit, në përfundim të transaksionit, shoqëria target ALBANIA GAS TECH SHA do të zotërohet plotësisht direkt nga JONUZ KASTRATI SHPK dhe indirekt nga shoqëria KASTRATI SHPK.
18. Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë ALBANIA GAS TECH SHA nga shoqëria JONUZ KASTRATI SHPK, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

19. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i import-eksport dhe tregti me shumicë i gazit të lëngshëm (GLN) dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
20. Tregu i shitjes së gazit të lëngshëm në Shqipëria përbën një segment të rëndësishëm të tregun e karburanteve, me përdorim të gjerë si për automjete ashtu edhe për përdorim familjar e industrial. LPG-ja në Shqipëri përdoret kryesisht për: furnizimin e automjeteve me gaz, pranë stacioneve të karburanteve; gatim dhe ngrohje familjare, kryesisht e bombola të volumeve të vogla; sektorin hotelier dhe bizneset; procese industriale dhe bujqësore.
21. E gjithë oferta në treg mbulohet nga importi dhe furnizimi realizohet kryesisht përmes porteve detare, sidomos në zonën e Porto Romanos në Durrës, ku ndodhen depozitat kryesore dhe terminalët e magazinimit.
22. Nga vlerësime të mëhershme të tregut të gazit, është evidentuar se tregu paraqet karakteristika të një tregu me përqendrim relativisht të lartë në nivel importi dhe magazinimi, ndërsa në nivel shpërndarjeje me pakicë paraqitet më i fragmentuar.
23. Tregu i importit dhe magazinimit paraqet barriera hyrëse për shkak të investimeve fillestare. Operatorë në këtë treg kanë kryer investime në kapacitete importuese dhe magazinuese, kanë

konsoliduar si rrjetet të shpërndarjes, ashtu edhe marrëdhëniet afatgjata të furnizimi të klientëve.

24. Në nivelin e pakicës, shitja realizohet pranë stacioneve të shitjes së karburanteve ose pranë dyqaneve të specializuar për shitjen e bombolave të gazit.
25. Nga vlerësimi i transaksionit u konstatua se shoqëria Target operon në tregu e importit dhe eksporti, shitjes dhe shpërndarjes më shumicë të gazit të lëngshëm (GLN). Konkurrentët e saj kryesorë janë A&V Gas International dhe Gega Center GKG, dhe nga vlerësimi i palës, shoqëria zotëron rreth xx% të tregut përkatës në Shqipëri.
26. Shoqëria blerëse Jonuz Kastrati SHPK, si dhe shoqëria Kastrati SHPK shërbejnë si shoqëri holding dhe përfshihen në kontrollin mbi shoqërisë Albanian Gas Tech SHA nuk krijon ndonjë mbivendosje tregjesh në mënyre direkte nga palët në transaksionin.
27. Vetëm shoqëria Kastrati Energy Trade, shoqëri e kontrolluar blerësi, ushtron aktivitet në tregun me pakicë të gazit përmes shitjes në pikat e karburantit dhe nga pala njoftuese vlerësohet se Kastrati Energy Trade zotëron vetëm xx% të tregut me pakicë.
28. Transaksioni i njoftuar krijon një mbivendosje vertikale mes shoqërive të kontrolluara nga Blerësi, por pjesa e kombinuar e tregut është me e vogël se 25%, duke mos ngritur shqetësimin për krijimin apo forcimin e pozitës dominuese në tregun përkatës.
29. Transaksionet e realizuara nga palët kanë patur për qëllime konsolidimin e pronësisë së Grupit Kastrati, dhe nuk sjellin ndryshime në aktivitetin tregtar të shoqërisë Target apo në strukturën e tregut ku ajo operon.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar për përfshimin e kontrollit të shoqërisë ALBANIA GAS TECH SHA nga shoqëria JONUZ KASTRATI SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1292, Datë 20.05.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRIVE GARANTI BANK SA DHE MOTORACTIVE IFN SA NGA SHOQËRIA RAIFFEISEN BANK SA.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërive GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA nga shoqëria RAIFFEISEN BANK SA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të vetëm të shoqërive GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA nga shoqëria RAIFFEISEN BANK SA”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërive GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA nga shoqëria RAIFFEISEN BANK SA.
2. Referuar dokumentit “Marrëveshje për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve”, palët në marrëveshje janë:

3. **Blerësi: RAIFFEISEN BANK SA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Rumanisë, e cila ofron një gamë të plotë produktesh dhe shërbimesh për individë privatë, ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe korporata të mëdha nëpërmjet kanaleve të shumta të shpërndarjes: pika bankare, rrjete ATM dhe EPOS, shërbime bankare telefonike (Raiffeisen Direct) dhe shërbime bankare mobile (myBanking).
4. RAIFFEISEN BANK SA është dega rumune e Grupit Ndërkombëtar të Bankës Raiffeisen (Grupi RBI), i cili është prezent dhe realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet RAIFFEISEN BANK SH.A, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare, si dhe çdo veprimtari tjetër të lidhur me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me veprimtarinë e saj, sipas licencës bankare të lëshuar nga Banka e Shqipërisë etj.
5. RAIFFEISEN BANK SH.A zotëron plotësisht: *RAIFFEISEN LEASING SHA*, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti veprimtari qeraje financiare, kredithënie etj, dhe *Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SHA*, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti administrimin e fondeve të pensionit privat nëpërmjet mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensioneve private në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” etj.
6. **Shitësit: Garanti Holding B.V.** dhe **G Netherlands B.V.** janë shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, të themeluara sipas ligjeve të Holandës.
7. **Target: GARANTI BANK SA** dhe **MOTORACTIVE IFN SA** janë shoqëri aksionare, të themeluara sipas ligjeve të Rumanisë, të zotëruara secila nga G Netherlands B.V. dhe Garanti Holding B.V., sipas aksioneve përkatëse. **Motoractive Multiservices S.R.L.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Rumanisë, një degë plotësisht në pronësi të MOTORACTIVE IFN SA.
8. Shoqëritë target përfshijnë biznesin rumun të Garanti BBVA, i cili ka zhvilluar ndër vite një portofol solid produktesh dhe shërbimesh bankare për të gjitha segmentet e biznesit: Retail, SME dhe Corporate, një portofol klientësh në rritje dhe të larmishëm, si dhe një rrjet të zgjeruar degësh në Rumani.
9. Shoqëritë Target nuk kanë filiale, degë apo zyra përfaqësimi të themeluara në Shqipëri.

II. Përqendrimi

10. Më datë [____], ndërmjet shoqërisë RAIFFEISEN BANK SA (blerësi) dhe shoqërive Garanti Holding B.V. dhe G Netherlands B.V. (shitësit) është nënshkruar Marrëveshje për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve, lidhur me blerjen e të gjithë kapitalit aksionar të emetuar të shoqërive GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA.

11. Sipas afateve dhe në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshje, shitësit kanë rënë dakord të shesin dhe blerësi ka rënë dakord të blejë dhe të paguajë për 100% të aksioneve për secilën prej shoqërive target GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA.
12. Pas mbylljes së transaksionit të propozuar, shoqëritë target GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA, duke përfshirë degën e kësaj të fundit plotësisht në pronësi Motoractive Multiservices S.R.L., do të zotërohen dhe kontrollohen plotësisht nga RAIFFEISEN BANK SA dhe si rrjedhojë, në mënyrë indirekte nga Grupi RBI.
13. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërive GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA nga shoqëria RAIFFEISEN BANK SA, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

14. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare dhe financiare, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
15. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërive GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA nga shoqëria RAIFFEISEN BANK SA.
16. RAIFFEISEN BANK SA është pjesë e Grupit Raiffeisen Bank International. Grupi RBI ofron shërbime universale bankare dhe financiare përmes disa degëve në Evropën Qendrore dhe Lindore, si edhe shërbime të tjera financiare në fushën e qirasë, menaxhimit të aseteve etj. Grupi RBI është prezent dhe realizon të ardhura në Shqipëri përmes RAIFFEISEN BANK SH.A, e cila ofron veprimtari bankare dhe financiare.
17. Shoqëritë target përfshijnë biznesin rumun të Garanti BBVA, i cili përfshin gjithashtu Garanti BBVA Leasing (marka nën të cilën operon Motoractive IFN SA) dhe Garanti BBVA Fleet Management (marka nën të cilën operon Motoractive Multiservices S.R.L.), të cilat plotësojnë ofertën e bankës me produkte specifike leasingu (leasing financiar për automjete, pajisje dhe pasuri të paluajtshme – sale & leaseback), shërbime të administrimit të flotës, si dhe kredi konsumatorë në Rumani.
18. Shoqëritë target nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.
19. Transaksioni i propozuar nuk krijon mbivendosje të aktivitetit ekonomik të palëve dhe nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut në Shqipëri.

20. Nga sa më sipër konstatojmë se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërive GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA nga shoqëria RAIFFEISEN BANK SA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1293, Datë 20.05.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. NGA SHOQËRIA HEIDELBERG MATERIALS AG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. nga shoqëria Heidelberg Materials AG.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit vetëm të shoqërisë AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. nga shoqëria Heidelberg Materials AG”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. nga shoqëria Heidelberg Materials AG.
2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:

3. **Blerësi: Heidelberg Materials AG** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: prodhimi dhe shpërndarja e materialeve të ndërtimit të të gjitha llojeve dhe produkteve të tjera të industrisë së gurit dhe dheut, sektorëve të lidhur dhe sektorëve të tjerë industrial, si dhe blerja dhe operimi i minierave, planifikimi, ndërtimi, blerja dhe operimi i objekteve për këto qëllime, planifikimi, ndërtimi dhe operimi i objekteve të tilla për palë të treta dhe ofrimi i shërbimeve të konsulencës për ta, etj.
4. Heidelberg Materials AG (shoqëria mëmë e grupit) është një shoqëri, kapitali i së cilës tregtohet në bursë. Në Shqipëri Blerësi zotëron indirekt shoqëritë:
 - Heidelberg Materials Eurotech Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila është aktive në importin dhe shitjen me shumicë të çimentos.
 - Shqipëria Cement Company SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila nuk ka kryer asnjë aktivitet që nga themelimi saj.
5. **Shitësi: HACI ÖMER SABANCI HOLDING ANONIM ŞİRKETİ** është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas legjislacionit të Turqisë, me fushë veprimtarie: aktivitete të shoqërive mëmë.
6. **Shoqëria target: AKÇANSA ÇİMENTO SANAYİ VE TİCARET A.Ş.** është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas legjislacionit të Turqisë, me objekt veprimtarie: prodhimi i të gjitha llojeve të çimentos, gëlqeres, klinkerit, të gjitha llojeve të betonit dhe të gjitha llojeve të materialeve të nevojshme, si dhe ndërtimi dhe operimi i fabrikave dhe objekteve të nevojshme për këtë qëllim, etj.
7. AKÇANSA ÇİMENTO SANAYİ VE TİCARET A.Ş. nuk ka asnjë filial të regjistruar në Shqipëri.

II. Përqendrimi

8. Më datë [...], ndërmjet shoqërisë HACI ÖMER SABANCI HOLDING ANONIM ŞİRKETİ dhe shoqërisë MORTELMAATSCHAPPIJ EINDHOVEN B.V. është nënshkruar “Marrëveshje e Aksionarëve”. Kjo Marrëveshje është ndryshuar herë pas here në të cilën Heidelberg Materials AG (e quajtur më parë Heidelberg Cement AG), u bë palë në dokumentin “Marrëveshje e Aksionarëve” më datë [...].
9. Referuar kësaj Marrëveshje, më datë [...], sipas një njoftimi të bërë nga shitësi HACI ÖMER SABANCI HOLDING ANONIM ŞİRKETİ për blerësin Heidelberg Materials AG, në përputhje me nenin 16(6) të Marrëveshje së Aksionarëve, shitësi ka informuar blerësin (i) për një ofertë detyruese nga një palë e tretë, e palidhur, lidhur me të gjitha aksionet e saj që përbëjnë xxx% të kapitalit aksionar të shoqërisë target (Aksionet e Ofruara), me qëllimin për shitjen e këtyre aksioneve; (ii) ofroi Aksionet e Ofruara tek shoqëria Heidelberg Materials AG dhe (iii)

- i kërkoj shoqërisë Heidelberg Materials AG, bazuar në nenin 16(6) të Marrëveshje së Aksionarëve, të deklaronte nëse do ta ushtronte të drejtën e saj për të blerë Aksionet e Ofruara.
10. Blerësi Heidelberg Materials AG i ka dërguar shitësit një njoftim përgjigje më datë [...] të bërë në përputhje me nenin 16(7) të Marrëveshje së Aksionarëve (Letra e Përgjigjes), ku Heidelberg Materials AG deklaroi gadishmërinë e saj për të blerë Aksionet e Ofruara.
11. Shkëmbimi i Njoftimit të Transferimit dhe Letra e Përgjigjes ndaj Njoftimit të Transferimit përbëjnë “ofertë” dhe “pranim” që rezultojnë në një marrëveshje detyruese midis palëve që nga data [...].
12. Blerësi Heidelberg Materials AG synon të blejë nga shitësi HACI ÖMER SABANCI HOLDING ANONIM ŞIRKETI, xx% aksione në kapitalin e shoqërisë AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. Para transaksionit shoqëritë zotëronin secila nga xx% të kapitalit aksionar të shoqërisë target (me pjesën e mbetur prej xx% që tregtohet në bursë), ku Heidelberg Materials AG dhe HACI ÖMER SABANCI HOLDING ANONIM ŞIRKETI, kishin kontroll të përbashkët mbi shoqërinë target.
13. Pas implementimit të transaksionit të propozuar, Heidelberg Materials AG do të ketë kontroll të vetëm mbi shoqërinë AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. duke zotëruar aksione që përfaqësojnë xx% të kapitalit aksionar të shoqërisë target.
14. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. nga shoqëria Heidelberg Materials AG, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

15. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me shumicë të çimentos, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur, dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
16. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. nga shoqëria Heidelberg Materials AG.
17. Heidelberg Materials AG është shoqëria holding e Heidelberg Materials Economic Group. HMEG është një prodhues i materialeve të ndërtimit që ofron, në veçanti, çimento, klinker dhe aditivë të tjerë të çimentos, aggregate, beton të gatshëm të përzier dhe produkte të tjera betoni,

llaç dhe asfalt. Blerësi ka dy filiale në pronësi indirekte, përkatësisht Heidelberg Materials Eurotech Albania SHPK dhe Shqipëria Cement Company SHPK.

18. AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. është një shoqëri aktive në prodhimin dhe komercializimin e çimentos dhe klinkerit; nxjerrjen, përpunimin dhe furnizimin komercial të agregateve, kryesisht përmes markës Agregasa. Target nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri, por gjeneron të ardhura në tregun shqiptar përmes shitjeve indirekte të produkteve të saj nga Heidelberg Materials Eurotech Albania SHPK.
19. Nga analiza e konkurrencës, u konstatua se përqendrimi i njoftuar nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjell ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë AKÇANSA ÇIMENTO SANAYI VE TICARET A.Ş. nga shoqëria Heidelberg Materials AG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr.1295, Datë 28.05.2026

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ
NDËRMARRJES SHPRESA - AL SHPK NË TREGUN E TRANSPORTIT URBAN NË
BASHKINË KAMËZ”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz.

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Nisur nga nga disa shqetësime të bëra publike në media dhe në bazë të disa ankesave të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me rritjen e çmimeve të biletave dhe aboneve të autobuzave të cilët operojnë në qytetin e Kamzës, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, filloi monitorimin për analizimin e kushteve të tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.
2. Referuar shkresës së Bashkisë Kamëz nr. 962/2 prot., datë 27.11.2025 “Kthim përgjigje”, Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban ka depozituar pranë Këshillit Bashkiak Kamëz

kërkesën duke argumentuar nevojën për rishikim dhe miratimin rritjes së çmimit të biletës së transportit urban me 10 (dhjetë) lekë, për linjën rrethqytetase mbi 8 km.

3. Kërkesa e Shoqatës së Transportit Urban dhe Interurban (protokolluar pranë Bashkisë Kamëz me nr. 7767 prot., datë 10.06.2025), argumentonte se çmimi i biletës prej 40 (dyzetë) lekë ishte i pamjaftueshëm për të përballuar kostot reale të shërbimit të transportit dhe për të garantuar një shërbim cilësor për qytetarët. Kjo kërkesë ishte e mbështetur në faktorët si vijon: (i) rritja e çmimit të karburantit, e cila ka rritur ndjeshëm kostot e përditshme të operimit; (ii) kosto më të larta të mirëmbajtjes dhe pjesëve të këmbimit; (iii) rritja e pagave minimale që ka reflektuar në rritjen e shpenzimeve për pagat e stafit teknik dhe drejtuesëve të mjeteve; (iv) rritja e trafikut të renduar që rrit kostot e përditshme në konsumin e karburantit.
4. Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 66, datë 26.09.2025 “Mbi miratimin e çmimit të biletave dhe aboneve të linjave të transportit urban në Bashkinë Kamëz”, miratoi rritjen e çmimit të biletave dhe aboneve për linjat e transportit urban mbi 8 km, për Linjën Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Linjën Paskuqan – Babrru – Tiranë. Për këto linja rritja u reflektua si vijon: tarifa e biletës të bëhet 50 (pesëdhjetë) lekë; tarifa e abonesë mujore të bëhet 1400 (një mijë e katërqind) lekë; tarifa e abonesë së përgjithshme të jetë 1600 (një mijë e gjashtëqind) lekë.
5. Referuar shkresës së Bashkisë Kamëz, për Linjën Kamëz – Tiranë – Kamëz, nëpërmjet Licencës nr. 31, lëshuar në datë 15.02.2017 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, është licencuar ndërmarrja SHPRESA - AL SHPK. Si dhe për linjën Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2, nëpërmjet Licencës nr. 33, lëshuar në datë 15.02.2017 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, është licencuar ndërmarrja SHPRESA - AL SHPK.
6. Në rastin konkret, SHPRESA - AL SHPK, zotëron pozitë dominuese në kuptim të Ligjit nr. 9121/2003, pasi është i vetmi subjekt i cili është i licencuar nga Bashkia Kamëz për të ofruar transportin urban në linjat Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Paskuqan – Babrru – Tiranë, çka e bën detyrimin për të justifikuar rritjen e çmimeve.
7. Çdo rritje tarife duhet të mbështetet në analiza të qarta të kostos, të cilat tregojnë se kostot e shërbimit janë rritur dhe se çmimi aktual nuk i mbulon më këto kosto, duke e bërë rritjen ekonomikisht të nevojshme.
8. As Bashkia Kamëz, as Shoqata e Transportit Urban nuk kanë administruar apo paraqitur të dhëna ekonomike apo financiare që të provojnë se rritja e kërkuar dhe miratuar është: e mbështetur në analizë të plotë të kostove; e nevojshme për të mbuluar kostot e rritura; e

arsyeshme dhe në përpjesëtim me shpenzimet reale të operatorit dhe e justifikuar mbi baza objektive të tregut.

9. Aktorët e biznesit kanë tendencë të keqpërdorin shoqatën e biznesit si një mjet për marrëveshje karteli ose praktika të tjera monopolistike, të kryera në mënyrë kolektive dhe sistematike përmes shoqatës së biznesit.¹ Kur një ndërmarrje ka pozitë dominuese, ekziston rreziku që çmimet të shtohen jo si pasojë e rritjes së kostove, por thjesht për shkak të mungesës alternative për konsumatorin.
10. Edhe pse shoqata nuk vendos çmimet vetë dhe nuk ka bashkëpunim midis konkurrentëve në këtë rast (sepse vetëm një operator operon në linjat përkatëse), roli i saj si përfaqësuese e operatorëve të transportit urban mund të justifikojë rritje çmimesh pa bazë objektive, duke lehtësuar mundësinë që ndërmarrja me pozitë dominuese të veprojë në dëm të konsumatorit.
11. Për sa më sipër, nisur nga problematika e ngritur, sjellja e ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK mund të përbente kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës bazuar në nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
12. Për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 1246, datë 12.12.2025, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz”, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz, për periudhën kohore nga 1 janar 2025 deri në 12 dhjetor 2025.
13. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion nga ndërmarrja SHPRESA - AL SHPK dhe Bashkia Kamëz.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

14. Në bazë të nenit 3, pika 7 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregu përkatës përbëhet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.

¹ OECD “Trade Associations” 2007, fq. 237

15. Në rastin konkret, tregu përkatës i produktit përfshin shërbimin e transportit urban/rrethqytetës të udhëtarëve me autobus, i ofruar në linjat Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2, përmes biletave të njëudhëtimit dhe aboneve mujore.
16. Nga këndvështrimi i zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës, konsumatorët që përdorin shërbimin e transportit urban në këto linja nuk kanë alternativa të tjera të arsyeshme dhe të krahësueshme për sa i përket çmimit, funksionit dhe aksesit. Mjetet private, taksitë apo forma të tjera transporti individual nuk konsiderohen produkte të zëvendësueshme, pasi: kanë kosto ndjeshëm më të larta; nuk janë të aksesueshme për të gjithë përdoruesit; nuk përmbushin funksionin social dhe publik të transportit urban.
17. Për rrjedhojë, tregu përkatës i produktit përkufizohet si tregu i shërbimit të transportit urban të udhëtarëve me autobus, i ofruar në linjat Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2.
18. Në rastin konkret, tregu gjeografik përfshin territorin e Bashkisë Kamëz, si dhe korridoret përkatëse të transportit urban që lidhin Kamzën me qytetin e Tiranës, konkretisht linjat Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2.
19. Për rrjedhojë, tregu përkatës gjeografik përkufizohet si zona ku shërbimi ofrohet përgjatë itinerareve të linjave Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

20. Në bazë të nenit 3, pika 5 të ligjit nr. 9121/2003, “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.”
21. Sipas ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 9121/2003.
22. Ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK nëpërmjet kontratës nr. 674 prot., datë 15.02.2017, dhe kontratës nr. 675 prot., datë 15.02.2017, i është dhënë e drejta nga Bashkia Kamëz të veprojë

si ndërmarrje e cila ofron shërbimin e transportit urban të udhëtarëve me autobus, i ofruar në linjat Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2.

23. Në bazë të këtyre kontratave, SHPRESA – AL SHPK është e detyruar të pajisë udhëtarët me biletë udhëtimi në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, si dhe të aplikojë çmimet e biletave dhe të biletave të pajtimit sipas vendimeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak Kamëz.
24. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve, fuqia kundërvepruese e konsumatorëve dhe blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja SHPRESA - AL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të transportit urban të udhëtarëve me autobus, i ofruar në linjat Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2, përgjatë itinerareve të linjave Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2 ka pozitë dominuese me 100% të tregut përkatës.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes SHPRESA – AL SHPK në tregun përkatës

25. Për Linjën Kamëz – Tiranë – Kamëz, nëpërmjet Licencës nr. 31, lëshuar në datë 15.02.2017 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, është licencuar ndërmarrja SHPRESA - AL SHPK. Si dhe për linjën Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2, nëpërmjet Licencës nr. 33, lëshuar në datë 15.02.2017 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, është licencuar ndërmarrja SHPRESA - AL SHPK.
26. Ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe ndërmarrjes SHPRESA – AL SHPK është nënshkruar “Kontrata për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetëse Kamëz – Tiranë – Kamëz”, me nr. 674 prot., datë 15.02.2017.
- Në nenin 3 të kësaj kontrate, Bashkia i jep të drejtën dhe kontraktori urban merr përsipër detyrimin e kryerjes së shërbimit të transportit urban të udhëtarëve për linjën rrethqytetëse Kamëz – Tiranë – Kamëz si dhe kryerjen e shërbimit për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi. Kjo kontratë ka vlefshmëri 10 (dhjetë) vjeçare, e cila do të jetë dhe data e vazhdimit të kontratës, konkretisht data 15.02.2017 deri 14.02.2027 me të drejtë ripërsëritje.
27. Gjithashtu është nënshkruar dhe “Kontrata për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetëse Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2”, me nr. 675 prot., datë 15.02.2017, për ofrimin e shërbimit të transportit urban të udhëtarëve me autobus në linjat përkatëse.

- Në nenin 3 të kësaj kontrate, Bashkia i jep të drejtën dhe kontraktori urban merr përsipër detyrimin e kryerjes së shërbimit të transportit urban të udhëtarëve për linjën rrethqytetase Kamëz – Tiranë – Kamëz si dhe kryerjen e shërbimit për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi. Kjo kontratë ka vlefshmëri 10 (dhjetë) vjeçare, e cila do të jetë dhe data e vazhdimit të kontratës, konkretisht data 16.02.2017 me të drejtë ripërsëritje.
- 28. Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban nëpërmjet shkresës së depozituar në Bashkinë Kamëz me nr. 7767 prot., datë 10.09.2025 “Kërkesë për rritjen e çmimit të biletave të transportit me 10 (dhjetë) lekë për linjat rrethytetase mbi 8 km”, ka argumentuar se çmimi i biletës prej 40 (dyzetë) lekë ishte i pamjaftueshëm për të përballuar kostot reale të shërbimit të transportit dhe për të garantuar një shërbim cilësor për qytetarët. Kjo kërkesë ishte e mbështetur në faktorët si vijon: (i) rritja e çmimit të karburantit, e cila ka rritur ndjeshëm kostot e përditshme të operimit; (ii) kosto më të larta të mirëmbajtjes dhe pjesëve të këmbimit; (iii) rritja e pagave minimale që ka reflektuar në rritjen e shpenzimeve për pagat e stafit teknik dhe drejtuesëve të mjeteve; (iv) rritja e trafikut të renduar që rrit kostot e përditshme në konsumin e karburantit.
- 29. Pas administrimit të kërkesës së Shoqatës së Transportit Urban dhe Interurban, Bashkia Kamëz ka ndërmarrë procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj. Çështja është futur në rendin e ditës së Këshillit Bashkiak, është përgatitur Projekt-Vendimi nr. 68, datë 23.09.2025 për “Miratimin e çmimit të biletave dhe aboneve të linjave të transportit urban në Bashkinë Kamëz”, si dhe relacioni shpjegues përkatës.
- 30. Gjithashtu, Bashkia Kamëz ka zhvilluar konsultime publike lidhur me projekt-vendimin, të cilat janë dokumentuar përmes njoftimeve dhe procesverbaleve përkatëse. Në përfundim të këtij procesi, Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 66, datë 26.09.2025 “Mbi miratimin e çmimit të biletave dhe aboneve të linjave të transportit urban në Bashkinë Kamëz”, miratoi rritjen e çmimit të biletave dhe aboneve për linjat e transportit urban mbi 8 km: për Linjën Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe për Linjën Paskuqan – Babrru – Tiranë. Për këto linja rritja² u reflektua si vijon: tarifa e biletës të bëhet 50 (pesëdhjetë) lekë; tarifa e abonesë mujore të bëhet 1400 (një mijë e katërqind) lekë; tarifa e abonesë së përgjithshme të jetë 1600 (një mijë e gjashtëqind) lekë.
- 31. Bashkia Kamëz ka sqaruar gjithashtu se: nuk ka pasur aplikime nga operatorë të tjerë për të operuar në këto linja; nuk ofron subvencione, kompensime apo mbështetje financiare për operatorët e transportit urban; ushtron monitorim dhe inspektim për zbatimin e detyrimeve kontraktuale nga operatori.

² Rritja ka reflektuar vetëm në: 10 lekë çmimi i biletës dhe në 200 lekë çmimi i abonesë mujore.

32. Në përgjigje të kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja SHPRESA – AL SHPK ka justifikuar rritjen e çmimeve duke iu referuar faktorëve ekonomikë dhe institucionalë, përfshirë inflacionin e akumuluar dhe krahasimet historike të nivelit të inflacionit, rritjen e pagës minimale, rritjen e çmimeve të karburantit, si dhe mungesën e subvencioneve apo skemave të kompensimit financiar nga Bashkia Kamëz.
33. Ndërmarrja SHPRESA - AL SHPK ka theksuar se: rritja e çmimit është aplikuar vetëm për dy linja të gjata (mbi 8 km); rritja është në nivel minimal prej 10 lekësh për biletën; rritja nuk prek biletat e abonimit, duke minimizuar ndikimin financiar për përdoruesit e rregullt të shërbimit.
34. SHPRESA – AL SHPK deklaron se nuk ka kryer investime në flotën e mjeteve, cilësinë e shërbimit dhe standartet teknike (psh. rinovim mjeteve, rritje kapaciteti, përmirësim shërbimi etj).
35. Z. Bardhok Osmani, i cili rezulton njëri nga administratorët e ndërmarrjes SHPRESA – AL SHPK, mban njëkohësisht edhe funksionin e anëtarit të Këshillit Bashkiak Kamëz³. Kjo përputhje rolesh ndërmjet një funksioni drejtues në ndërmarrjen që operon në tregun përkatës dhe një funksioni në organin vendimmarrës vendor përbën një element që merret në konsideratë në analizën konkurruese të sjelljes së ndërmarrjes, veçanërisht në kontekstin e procesit të rishikimit të tarifave dhe të kushteve të ushtrimit të aktivitetit në një treg ku mungon konkurrenca efektive.
36. Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar rezulton se ndërmarrja SHPRESA – AL SHPK nuk ka paraqitur pranë AK apo Këshillit Bashkiak të Bashkisë Kamëz, një analizë të plotë, të strukturuar dhe të verifikueshme të kostove të shërbimit të transportit për asnjë vit që ka operuar në këto dy linja. Informacioni i ofruar është i fragmentuar, përshtues dhe kryesisht krahasimor në kohë. Ky informacion nuk mundëson përcaktimin e qartë të kostos reale për një pasagjer apo të strukturës së përgjithshme të kostove operative të ndërmarrjes. Për rrjedhojë, nuk provohet në mënyrë objektive dhe proporcionale lidhja shkak-pasojë ndërmjet rritjes së tarifave për pasagjer (bileta dhe pajtimi) dhe rritjes konkrete të kostove të shërbimit për pasagjer.
37. Gjithashtu, konstatohet një mospërputhje midis deklarimeve të ndërmarrjes dhe të dhënave zyrtare të Bashkisë Kamëz, lidhur me shtrirjen e rritjes së çmimeve. Ndërsa ndërmarrja deklaron se rritja nuk ka prekur abonetë ndërsa Vendimi nr. 66, datë 26.09.2025 i Bashkisë

³ sipas listës së Këshilltrëve të Bashkisë Kamëz 2025 (shkresa nr 962/9 prot., datë 08.01.2026, dërguar nga Bashkia Kamëz)

Kamëz parashikon rritje edhe të tarifave të abonesë mujore me 200 lekë për linjat rrethqytetëse mbi 8 km.

38. Në kushtet kur ndërmarrja SHPRESA – AL SHPK, vepron në një treg ku zotëron pozitë dominuese, aplikon rritje çmimi pa mbështetje të mjaftueshme në një analizë të provuar kosto–çmim dhe operon në një mjedis ku konsumatorët nuk kanë fuqi kundërvepruese efektive, sjellja e saj mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2 germa (a) të ligjit nr. 9121/2003, veçanërisht në aspektin e aplikimit të çmimeve potencialisht të padrejta ose jo të justifikuara.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2025 deri në 20 maj 2026.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr.1296, Datë 28.05.2026

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1280, DATË 27.03.2026 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË CIGAREVE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1280, datë 27.03.2026 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve”.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1280, datë 27.03.2026 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraparak për të vlerësuar strukturën e tregut dhe të sjelljes të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar nëse këto sjellje mund të përbëjnë shkelje të nenit 9 dhe/ose nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003, për periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 27 mars 2026.
2. Për realizimin e procedurave hetimore bazuar në nenin 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacione nga

ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve, nga Drejtoria Përgjithshme e Doganave dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatitimeve.

3. Lidhur me kërkesat për informacion drejtuar ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve, disa prej ndërmarrjeve kanë kërkuar shtyrje afati për paraqitjen e informacionit të kërkuar. Gjithashtu, një pjesë e ndërmarrjeve nuk kanë kthyer informacionin e kërkuar, pavarësisht rikërkesave të përsëritura nga Autoriteti i Konkurrencës, ndërsa një pjesë tjetër kanë paraqitur informacion të paplotë ose që ka kërkuar saktësime dhe plotësime të mëtejshme. Për rrjedhojë, koha e mbetur në dispozicion pas administrimit të informacionit rezulton e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe analizimin e plotë të sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke e bërë të pamundur përfundimin e procedurave hetimore dhe paraqitjen e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 1280, datë 27.03.2026 të Komisionit të Konkurrencës.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraparak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës, nr. 1280, datë 27.03.2026 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve” pika “III”, të ndryshohet si vijon:

“III. Raporti i hetimit paraparak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 3 Korrik 2026.”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1297, Datë 28.05.2026

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 1169, DATË 26.03.2025 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES ARLIS ADMINISTRIM SHPK NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË”.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1169, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe neni 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të monitorimit mbi zbatimin e vendimeve nr. 1168, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen D&L Administrim SHPK, nr. 1169, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, nr. 1170, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK, nr. 1143, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen S&D Invest SHA, nr. 1144, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Acrem SHPK, nr. 1145, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi raportin e monitorimit mbi zbatimin e vendimeve nr. 1168, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen D&L Administrim SHPK, nr. 1169, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK,

nr. 1170, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK, nr. 1143, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen S&D Invest SHA, nr. 1144, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Acrem SHPK, nr. 1145, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK;

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1169, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, ka vendosur:
 - I. *Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.*
 - II. *Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.*
2. AK në vijim të monitorimit, nëpërmjet shkresës nr. 903 prot., datë 10.10.2025 ka kërkuar informacion nga ndërmarrjet: One Albania SHA, Vodafone Albania SHA, Abissnet SHA, Albanian Satellite Communications SHPK, Digicom SHPK, Pronet SHPK dhe Selcom SHPK lidhur me rastet e refuzimit të aksesit si dhe ju është kërkuar vënia në dispozicion e provave dhe fakteve të refuzimit të aksesit (Prova të cilat mund të jenë email të shkëmbyera, minuta takimi, mesazhe, procesverbale etj).
3. Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e administruar gjatë periudhës së monitorimit, nuk rezultojnë prova konkrete që të evidentojnë refuzim të aksesit apo sjellje kufizuese nga ana e ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK. Pretendimet e ngritura nga ndërmarrjet e ofrimit të shërbimit të internetit mbeten kryesisht në nivel komunikimesh verbale dhe nuk janë të mbështetura në dokumentacion provues.
4. Si përfundim, në mungesë të provave konkrete që të evidentojnë kufizim të aksesit apo sjellje në kundërshtim me ligjin, vlerësohet se ndërmarrja Arlis Administrim SHPK ka respektuar detyrimet që burojnë nga vendimi gjatë periudhës së monitorimit, si dhe nuk evidentohet sjellje që të përbëjë shkelje të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1169, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1298, Datë 28.05.2026

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 1144, DATË 27.12.2024 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN ACREM SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1144, datë 27.12.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Acrem SHPK”.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe neni 26, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të monitorimit mbi zbatimin e vendimeve nr. 1168, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen D&L Administrim SHPK, nr. 1169, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, nr. 1170, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK, nr. 1143, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen S&D Invest SHA, nr. 1144, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Acrem SHPK, nr. 1145, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi raportin e monitorimit mbi zbatimin e vendimeve nr. 1168, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen D&L

Administrim SHPK, nr. 1169, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, nr. 1170, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK, nr. 1143, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen S&D Invest SHA, nr. 1144, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Acrem SHPK, nr. 1145, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK;

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1144, datë 27.12.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Acrem SHPK”, ka vendosur:
 - I. *Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Acrem SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.*
 - II. *Detyrimin e ndërmarrjes Acrem SHPK që brenda 90 ditëve të rishikojë nenin 5, pika 5.6 “Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit” në kontratat e bashkëpunimit e lidhura për shfrytëzimin e infrastrukturës së telekomunikacionit në kompleksin Rolling Hills, si një dispozitë e cila të mos kufizojë të drejtën e aksesit për ofrimin e shërbimit të internetit si dhe mos të jetë në kundërshtim me nenin 9, pika 2, germa (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.*
 - III. *Detyrimin e ndërmarrjes Acrem SHPK për të mos abuzuar me pozitën dominuese, veçanërisht:*
 - e) *vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;*
 - f) *kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;*
 - g) *zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
 - h) *vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.*
 - IV. *Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Acrem SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.*

- V. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Acrem SHPK, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të Ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.*
2. AK në vijim të monitorimit, nëpërmjet shkresës nr. 903 prot., datë 10.10.2025 ka kërkuar informacion nga ndërmarrjet: One Albania SHA, Vodafone Albania SHA, Abissnet SHA, Albanian Satellite Communications SHPK, Digicom SHPK, Pronet SHPK dhe Selcom SHPK si dhe nëpërmjet shkresës nr. 96 prot., datë 29.01.2026 “Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1144, datë 27.12.2024”, ka kërkuar informacion ndaj ndërmarrjes Acrem SHPK mbi zbatimin e pikës (II) dhe (III) të VKK nr. 1144, datë 27.12.2024
 3. Ndërmarrja Acrem SHPK nëpërmjet shkresës protokolluar pranë AK me nr. 96/1 prot., datë 13.02.2026 “SHKRESË ZYRTARE”, ka depozituar informacionin në lidhje me zbatimin e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në VKK nr. 1144/2024.
 4. Nga administrimi dhe përpunimi i informacionit për ndërmarrjen Acrem SHPK, konstatohet si më poshtë vijon:
 - i. Lidhur me zbatimin e pikës II të VKK nr. 1144/2024: Detyrimin e ndërmarrjes Acrem SHPK që brenda 90 ditëve të rishikojë nenin 5, pika 5.6 “Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit” në kontratat e bashkëpunimit e lidhura për shfrytëzimin e infrastrukturës së telekomunikacionit në kompleksin XXX, si një dispozitë e cila të mos kufizojë të drejtën e aksesit për ofrimin e shërbimit të internetit si dhe mos të jetë në kundërshtim me nenin 9, pika 2, germa (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.*
 5. Ndërmarrja Acrem SHPK ka sqaruar se, në kontratat e bashkëpunimit për shfrytëzimin e infrastrukturës së telekomunikacionit për rezidencën e “XXX”, neni 5 (“Të drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit”) nuk përmban nën-pikë “5.6”. Për saktësi, ndërmarrja Acrem SHPK ka konsideruar se referenca në shkresën e AK lidhet me pikën 5.2, shkronja “c”, të modeleve kontraktuale të vitit 2024 ku parashikohej se “ACREM ka të drejtë, pa njoftim paraprak të pezullojë gëzimin e të drejtave sipas kësaj Kontrate nga ana e Qiramarrësit, duke përfshirë por pa u kufizuar në ndalimin e aksesit të personelit të Operatorit të Internetit në brendësi të ambjenteve të Kompleksit, në rast se Qiramarrësi nuk përmbush detyrimin për pagesën e ndonjë fature për detyrim qiraje ose kamatëvonesave brenda afateve të parashikuara në Kontratë”. Nga verifikimi i kontratave të vitit 2025 të vendosura në dispozicion nga ndërmarrja Acrem SHPK rezulton se ky parashikim është rishikuar dhe hequr, me qëllim që të

mos kufizohet e drejta e aksesit për ofrimin e shërbimit të internetit dhe të sigurohet përputhshmëria me kuadrin ligjor përkatës.

- ii. *Lidhur me zbatimin e pikës III të VKK nr. 1144/2024: Detyrimin e ndërmarrjes Acrem SHPK për të mos abuzuar me pozitën dominuese, veçanërisht: (a) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit; (b) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik; (c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; (d) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.*
6. Ndërmarrja Acrem SHPK ka informuar se, se kontratat e vitit 2024 kanë patur afat vlefshmërie deri në datën 31.12.2024, dhe paralelisht kontratat e vitit 2025 nuk përmbajnë dispozita kufizuese për aksesin e operatorëve. Ndërmarrja Acrem SHPK ka konfirmuar se nuk aplikon dhe nuk do të aplikojë dispozita kontraktuale që krijojnë ekskluzivitete apo kufizime të pajustificuara për aksesin e operatorëve të komunikimeve elektronike në infrastrukturën e telekomunikacionit, duke garantuar kushte transparente, të barabarta dhe jodiskriminuese, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Bashkëlidhur ka vendosur në dispozicion dhe kontratat e bashkëpunimit për shfrytëzimin e infrastrukturës së telekomunikacionit për vitin 2025 me ndërmarrjet: XXX; XXX; XXX; XXX; XXX dhe XXX.
7. Gjithashtu edhe nga informacioni i marrë nga ndërmarrjet e ofrimit të shërbimit të internetit nuk rezultojnë ankesa apo problematika të mbështetura në prova apo dokumentacion të shkruar në lidhje me kufizimin e aksesit.
8. Si përfundim, në mungesë të provave konkrete që të evidentojnë kufizim të aksesit apo sjellje në kundërshtim me detyrimet e vendimit, vlerësohet se ndërmarrja Acrem SHPK gjatë periudhës së monitorimit ka zbatuar detyrimet e përcaktuara në VKK nr. 1144, datë 27.12.2024, si dhe nuk evidentohet sjellje që të përbëjë shkelje të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1144, datë 27.12.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Acrem SHPK”.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1299, Datë 28.05.2026

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 1168, DATË 26.03.2025 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES D&L ADMINISTRIM SHPK NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1168, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes D&L Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe neni 26, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të monitorimit mbi zbatimin e vendimeve nr. 1168, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen D&L Administrim SHPK, nr. 1169, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, nr. 1170, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK, nr. 1143, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen S&D Invest SHA, nr. 1144, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Acrem SHPK, nr. 1145, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi raportin e monitorimit mbi zbatimin e vendimeve nr. 1168, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen D&L Administrim SHPK, nr. 1169, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, nr. 1170, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK, nr. 1143, datë

27.12.2024 për ndërmarrjen S&D Invest SHA, nr. 1144, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Acrem SHPK, nr. 1145, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK;

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1168, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes D&L Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, ka vendosur:
 - I. *Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes D&L Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.*
 - II. *Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes D&L Administrim SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.*
2. AK në vijim të monitorimit, nëpërmjet shkresës nr. 903 prot., datë 10.10.2025 ka kërkuar informacion nga ndërmarrjet: One Albania SHA, Vodafone Albania SHA, Abissnet SHA, Albanian Satellite Communications SHPK, Digicom SHPK, Pronet SHPK dhe Selcom SHPK lidhur me rastet e refuzimit të aksesit si dhe ju është kërkuar vënia në dispozicion e provave dhe fakteve të refuzimit të aksesit (Prova të cilat mund të jenë email të shkëmbyera, minuta takimi, mesazhe, procesverbale etj).
3. Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e administruar gjatë periudhës së monitorimit, nuk rezultojnë prova konkrete që të evidentojnë kufizim të aksesit për operatorët e komunikimeve elektronike në rezidencat e administruara nga ndërmarrja D&L Administrim SHPK. Pretendimet e raportuara nga operatorët mbeten kryesisht në nivel komunikimesh verbale dhe nuk janë të mbështetura në dokumentacion provues.
4. Si përfundim, në mungesë të provave konkrete që të evidentojnë sjellje në kundërshtim me ligjin, vlerësohet se ndërmarrja D&L Administrim SHPK ka respektuar detyrimet që burojnë nga vendimi gjatë periudhës së monitorimit, si dhe nuk evidentohet shkelje e ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1168, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes D&L Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1300, Datë 28.05.2026

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 1170, DATË 26.03.2025 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES SAFE SECURITY ALBANIA SHPK NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË”.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1170, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Safe Security Albania SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe neni 26, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të monitorimit mbi zbatimin e vendimeve nr. 1168, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen D&L Administrim SHPK, nr. 1169, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, nr. 1170, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK, nr. 1143, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen S&D Invest SHA, nr. 1144, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Acrem SHPK, nr. 1145, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi raportin e monitorimit mbi zbatimin e vendimeve nr. 1168, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen D&L Administrim SHPK, nr. 1169, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, nr. 1170, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK, nr. 1143, datë

27.12.2024 për ndërmarrjen S&D Invest SHA, nr. 1144, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Acrem SHPK, nr. 1145, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK;

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1170, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Safe Security Albania SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi:
 - I. *Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Safe Security Albania SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.*
 - II. *Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Safe Security Albania SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.*
2. AK në vijim të monitorimit, nëpërmjet shkresës nr. 903 prot., datë 10.10.2025 ka kërkuar informacion nga ndërmarrjet: One Albania SHA, Vodafone Albania SHA, Abissnet SHA, Albanian Satellite Communications SHPK, Digicom SHPK, Pronet SHPK dhe Selcom SHPK lidhur me rastet e refuzimit të aksesit si dhe ju është kërkuar vënia në dispozicion e provave dhe fakteve të refuzimit të aksesit (Prova të cilat mund të jenë email të shkëmbyera, minuta takimi, mesazhe, procesverbale etj).
3. Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e administruar gjatë periudhës së monitorimit, nuk rezultojnë prova konkrete që të evidentojnë kufizim të aksesit apo sjellje diskriminuese nga ana e ndërmarrjes Safe Security Albania SHPK. Pretendimet e ngritura nga operatorët e tregut mbeten të pambështetura në dokumentacion të shkruar dhe nuk mund të verifikohen në mënyrë objektive.
4. Si përfundim, në mungesë të provave konkrete që të evidentojnë sjellje në kundërshtim me ligjin, vlerësohet se ndërmarrja Safe Security Albania SHPK ka respektuar detyrimet që burojnë nga vendimi gjatë periudhës së monitorimit, si dhe nuk evidentohet sjellje që të përbëjë shkelje të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1170, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Safe Security Albania SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr1301, Datë 28.05.2026

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 1143, DATË 27.12.2024, “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN S&D INVEST SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1143, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen S&D Invest SHA”.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe neni 26, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të monitorimit mbi zbatimin e vendimeve nr. 1168, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen D&L Administrim SHPK, nr. 1169, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, nr. 1170, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK, nr. 1143, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen S&D Invest SHA, nr. 1144, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Acrem SHPK, nr. 1145, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi raportin e monitorimit mbi zbatimin e vendimeve nr. 1168, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen D&L Administrim SHPK, nr. 1169, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, nr. 1170, datë 26.03.2025 për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK, nr. 1143, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen S&D Invest SHA, nr. 1144, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Acrem SHPK, nr. 1145, datë 27.12.2024 për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK;

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1143, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen S&D Invest SHA”, ka vendosur:
 - I. *Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes S&D Invest SHA në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.*
 - II. *Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja S&D Invest SHA si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si vijon:*
 1. *Ndërmarrja S&D Invest SHA ka detyrimin që në rezidencat e administruara prej saj, të lejojë aksesin dhe për ndërmarrjet e tjera të cilat e kërkojnë këtë akses për të ofruar shërbimin e internetit.*
 2. *Ndërmarrja S&D Invest SHA ka detyrimin të mos abuzojë me pozitën dominuese, veçanërisht:*
 - a) *vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;*
 - b) *kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;*
 - c) *zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
 - d) *vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë*

- III. *Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes S&D Invest SHA në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarra ka në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.*
- IV. *Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja S&D Invest SHA, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të Ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.*
2. AK në vijim të monitorimit, nëpërmjet shkresës nr. 903 prot., datë 10.10.2025 ka kërkuar informacion nga ndërmarrjet: One Albania SHA, Vodafone Albania SHA, Abissnet SHA, Albanian Satellite Communications SHPK, Digicom SHPK, Pronet SHPK dhe Selcom SHPK si dhe nëpërmjet shkresës nr. 98 prot., datë 29.01.2026 “Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1143, datë 27.12.2024”, ka kërkuar informacion ndaj ndërmarrjes S&D Invest SHA lidhur me zbatimin e pikës (II) të VKK nr. 1143, datë 27.12.2024.
3. Ndërmarrja S&D Invest SHA nëpërmjet shkresës protokolluar pranë AK me nr. 98/1 prot., datë 25.02.2026 “Raportim mbi zbatimin e VKK nr. 1143, datë 27.12.2024”, ka vënë në dispozicion masat e ndërmarra në kuadër të zbatimit të VKK nr.1143, datë 27.12.2024.
4. Nga administrimi dhe përpunimi i informacionit për ndërmarrjen S&D Invest SHA, konstatohet si më poshtë vijon:
- i. *Lidhur me zbatimin e pikës II/1 të VKK nr. 1143/2024: Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja S&D Invest SHA si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si vijon: Ndërmarrja S&D Invest SHA ka detyrimin që në rezidencat e administruara prej saj, të lejojë aksesin dhe për ndërmarrjet e tjera të cilat e kërkojnë këtë akses për të ofruar shërbimin e internetit.*
5. Ndërmarrja ndërmarrja S&D Invest SHA ka vënë në dispozicion komunikimet me ndërmarrjen XXX së cilës i është lejuar aksesin për të dhënë shërbimin e internetit për një nga abonentët e saj në rezidencën XXX. Në këtë komunikim përfshihet edhe një shkresë drejtuar shoqërisë XXX në të cilën S&D Invest bën me dije se teknika e shoqërisë XXX nuk ka mundur të kryejë lidhjen për shkaqe të panjohura. Megjithatë shihet se në shkresën drejtuar kompanisë XXX, ndërmarrja S&D Invest insiston në vendosjen e një datë fikse për të kryer ndërhyrjet e nevojshme në rrjet në mënyrë që të mundësohet aksesin i internetit në godinen përkatëse. Përveç kësaj kompanie të ofrimit të shërbimit të internetit, S&D Invest nuk ka patur kërkesa të tjera për dhënie aksesin në rrjet.

- ii. *Lidhur me zbatimin e pikës II/2 të VKK nr. 1143/2024: Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja S&D Invest SHA si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si vijon: Ndërmarrja S&D Invest SHA ka detyrimin të mos abuzojë me pozitën dominuese, veçanërisht:*
- a) *vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;*
 - b) *kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;*
 - c) *zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
 - d) *vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë*
6. Ndërmarrja ndërmarrja S&D Invest SHA ka bërë me dije se, ka shmangur vendosjen e çmimeve apo kushteve të padrejta tregtimit si edhe nuk ka vendosur kufizime në tregjet teknike duke zbatuar me rigorozitet kushtet dhe detyrimet në mënyrë që të minimizojë çdo kusht i cili në mënyrë të tërthortë apo të drejtpërdrejtë krijon pabarazi për veprime tregtare të njëjta. Gjithashtu, ndërmarrja S&D Invest ka vënë në dispozicion një kontratë sipërmarrjeje tashmë të modifikuar, duke hequr nga kontrata një pjesë të nenit i cili parashikonte disa specifikime teknike. Bëhet fjalë për dispozitën ku përmendej se “*Kontrata me kompaninë e internetit është detyrë dhe e drejtë e zhvilluesit dhe është përgjegjësi financiare e porositësit*”. Kontrata e vënë në dispozicion nga S&D Invest nuk përmban më një dispozitivë të tillë, e cila krijonte kushte të padrejta tregtimi duke hequr lirinë e konsumatorit për të përzgjedhur operatorin e ofrimit e shërbimit të internetit.
7. Ndërmarrjeve e ofrimit të shërbimit të internetit, të pyetura nëse kanë patur vëshitirësi në lejimin e aksesit për ofrimin e këtij shërbimi në komplekset e administruara nga ndërmarrja S&D Invest, janë shprehur si më poshtë:
- a. Ndërmarrja One Albania SHA ka shprehur se përsëri nuk lejohet të implementojë rrjetin në rezidencën XXX, duke pretenduar se S&D Invest ka marrëveshje ekskluzive me ofruesin e shërbimit të internetit XXX. Megjithatë S&D Invest ka raportuar se pikërisht më këtë ndërmarrje ka bërë të mundur ofrimin e aksesit në rastin e sipërm.
 - b. Ndërmarrja Abissnet SHA gjithashtu ka bërë me dije se përsëri nuk ka akses në Rezidencat XXX. Megjithatë, Abissnet SHA nuk ka vënë në dispozicion asnjë provë konkrete të mos lejimit të aksesit përveçse komunikimit verbal.
8. Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e administruar gjatë periudhës së monitorimit, rezulton se ndërmarrja S&D Invest SHA ka ndërmarrë masa konkrete në drejtim të zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në VKK nr. 1143, datë 27.12.2024, veçanërisht në drejtim të lejimit

të aksesit për operatorët e tjerë (rasti XXX) dhe rishikimit të kushteve kontraktuale. Nga informacioni i marrë nga ndërmarrjet e ofrimit të shërbimit të internetit rezultojnë pretendime për kufizim të aksesit në disa rezidenca, të cilat megjithatë nuk janë të mbështetura në prova apo dokumentacion të shkruar.

9. Si përfundim, në mungesë të provave konkrete që të evidentojnë kufizim të aksesit apo sjellje në kundërshtim me detyrimet e vendimit, vlerësohet se ndërmarrja S&D Invest SHA gjatë periudhës së monitorimit ka zbatuar detyrimet e përcaktuara në VKK nr. 1143, datë 27.12.2024.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d) dhe nenin 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1143, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen S&D Invest SHA”.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1302, Datë 28.05.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË EKONOMIKE TË RRJETIT TË MARKETEVË “ECO MARKET” NGA SHOQËRIA SPAR ALBANIA SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të veprimtarisë ekonomike të rrjetit të marketeve “Eco Market” nga shoqëria Spar Albania SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendriveve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të veprimtarisë ekonomike të rrjetit të marketeve “Eco Market” nga shoqëria Spar Albania SHPK”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të veprimtarisë ekonomike të rrjetit të marketeve “Eco Market” nga shoqëria Spar Albania SHPK.
2. Referuar dokumentit “Kontratë shitje pasuri e luajtshme”, nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:

3. **Pala blerëse: Spar Albania SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë: ngritjen, hapjen dhe administrimin të marketeve, supermarketeve dhe hipermarketeve “Spar” në Shqipëri dhe jashtë saj; import-eksport dhe /ose kultivim, prodhim, përpunim i produkteve ushqimore; import-eksport dhe /ose prodhimi i produkteve jo-ushqimore; shitja me shumicë dhe/ose pakicë e produkteve ushqimore të përpunuara ose të papërpunuara dhe jo-ushqimore; stokimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore të përpunuara ose të papërpunuara dhe jo-ushqimore; transport i mallrave dhe udhëtareve brenda dhe jashtë vendit, shërbime të ndryshme konsulence. Gjithashtu shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksioni tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloj natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen ose plotësimin e objektivit të shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.
4. Spar Albania SHPK zotëron një rrjet supermarketesh në Shqipëri, që operon në markën ndërkombëtare Spar, e cila zotërohet 100% nga ortaku i vetëm i saj Viva Fresh SHPK.
5. **Pala shitëse: D & D Distribution SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari në fushën e prodhimit, magazinimit e tregtimit të prodhimit të ushqimeve blegtorale dhe bujqësore, dhe furrë buke. Tregti, import-eksport duke përfshirë magazinimin dhe tregtimin me shumicë dhe me pakicë të mallrave ushqimore, industriale, elektroshtëpiake, duhanit dhe cigareve, pijeve të ndryshme alkoolike ose jo, automjeteve, makinerive e pjesëve të këmbimit për to dhe të lëndëve drusore, etj. Veprimtari në fushën e industrisë blegtorale e ushqimore, ndërtimit dhe tregtimit etj. Veprimtari tregtare të transportit të mallrave/produkteve të ndryshme ushqimore brenda vendit edhe për persona të tretë, me qira si dhe për llogari të tij. Transport mallrash/produkte ndërkombëtare, për persona të tretë me qira si dhe për llogari të tij. Projektimi, realizimi, menaxhimi dhe kontrolli i sistemeve informatike dhe të programeve aplikative, si dhe ushtrimin e aktivitetit informatik dhe telematik të kryer në favor të të tretëve, përpunimin e të dhënave për të tretët, realizimin e shitjes së produkteve editorial etj.
6. Aksionar të kësaj shoqërie janë z. Armand Duka me 50% të kuotave dhe z. Agron Duka me 50% të kuotave.
7. **Shoqëria target: Rrjeti i marketeve “Eco Market”**, me zotërues të vetëm shoqërinë D & D Distribution SHPK, i cili do t’i transferohet shoqërisë Spar Albania SHPK.

II. Përqendrimi

8. Më datë [...] është lidhur “Kontratë shitje pasuri e luajtshme” ndërmjet shoqërisë Spar Albania SHPK (blerësi) dhe shoqërisë D & D Distribution SHPK (shitësi), si palë të kësaj kontrate.

9. D & D Distribution SHPK me nënshkrimin e kësaj kontrate i transferon shoqërisë Spar Albania SHPK, e cila e pranon këtë transferim nëpërmjet shitjes së një pjese të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjes, konkretisht rrjetin e marketeve “Eco Market”.
10. Me “Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë”, datë [...] nga pala blerëse është miratuar realizimi i transferimit nëpërmjet blerjes vetëm të një pjese të aktivitetit ekonomik (konkretisht rrjetin e marketeve Eco Market, gjithsej 16 markete) të shoqërisë D & D Distribution SHPK.
11. Shoqëria D & D Distribution SHPK me nënshkrimin e Marrëveshjes i transferon shoqërisë Spar Albania SHPK, e cila e pranon këtë transferim nëpërmjet shitjes së një pjese të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjes, konkretisht rrjetin e marketeve “Eco Market”, e cila përfshin zërat:
12. Transferimin e plotë të aseteve që përfshijnë: (i) Pasuri të luajtshme të prekshme, përfshirë pajisjet, raftet, makineritë dhe çdo pajisje tjetër të prekshme ekzistuese në datën e realizimit të transferimit që përdoren për ushtrimin e aktivitetit ekonomik; (ii) Transferimin e kontratave të qirave të cilat duhen të lidhen direkt mes Spar Albania SHPK dhe qiradhënësve për 16 njësitë/marketet ku shitësi operon, sipas periudhave dhe nivelit të qirave; (iii) Punonjësit operacional që rezultojnë të punësuar në datën e realizimit të transferimit dhe (iv) Shitjen dhe transferimin e stokut ekzistues, sipas gjendjes faktike në momentin e realizimit të transaksionit.
13. Palët deklarojnë se veprimtaria ekonomike që transferohet nëpërmjet shitjes së një pjese të aktivitetit ekonomik, ka një autonomi ekonomike dhe do të funksionojë si e pavarur nga shoqëria D & D Distribution SHPK.
14. Rrjeti i marketeve “Eco Market” do t’i transferohet shoqërisë Spar Albania SHPK dhe do të jetë i lirë nga çdo barrë dhe detyrim.
15. Palët bien dakord dhe deklarojnë se brenda 90 ditëve pune do të përmbushin realizimin e objektit të kësaj kontrate.
16. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të veprimtarisë ekonomike të rrjetit të marketeve “Eco Market” nga shoqëria Spar Albania SHPK, transaksion i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e konkurrencës

17. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me pakicë të produkteve ushqimore dhe produkteve jo ushqimore. Për analizimin e këtij rasti, *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

18. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të veprimtarisë ekonomike të rrjetit të marketeve “Eco Market” nga shoqëria Spar Albania SHPK.
19. Spar Albania SHPK është një shoqëri shqiptare e cila operon përmes rrjetit të saj të marketeve, supermarketeve dhe hipermarketeve nën markën ndërkombëtare “SPAR”.
20. Rrjeti i marketeve “Eco Market” përfshin 16 njësi të vendosura në Tiranë, Durrës dhe Fier.
21. Tregu i shitjes me pakicë të produkteve ushqimore dhe të konsumit të përditshëm mbetet një treg dinamik dhe konkurrues, ku operojnë një numër i konsiderueshëm supermarketesh, hipermarketesh dhe rrjetesh të tjera tregtare.
22. Transaksioni nuk do të sjellë ndryshime thelbësore në strukturën konkurruese të tregut në Shqipëri pasi blerësi zotëron rreth xx% të tregut përkatës, ndërsa shoqëria target ka një pjesë tregu relativisht të kufizuar prej rreth xx%.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të veprimtarisë ekonomike të rrjetit të marketeve “Eco Market” nga shoqëria Spar Albania SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1303, Datë 26.06.2026

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E
PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE I-FIRE SHPK DHE P.F. AERD
MAHMUTAJ”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.06.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE:

1. Agjencia e Prokurimit Publik (APP), nëpërmjet shkresës nr. 7291/1/4 prot., datë 16.12.2025, (protokolluar pranë AK me nr. 1133 prot., datë 24.12.2025), ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës një rast mbi dyshimin për marrëveshje në oferta ndërmjet operatorëve ekonomikë i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj.
2. APP, nëpërmjet kësaj shkrese, ka bërë me dije se pranë saj është depozituar ankesa e ndërmarrjes Victoria-Al SHPK, me objekt kërkesën për nisjen e procedurave administrative ndaj operatorëve ekonomikë i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj, duke pretenduar se operatori ekonomik Aerd Mahmutaj P.F. përdor të dhëna identifikuese që i përkasin ndërmarrjes i-Fire" SHPK (emër, adresë, e-mail, kontakte). Sipas ankuesit, dy operatorët

ekonomikë ushtrojnë aktivitet si një njësi ekonomike e vetme. Personi fizik Aerd Mahmutaj përdor logon dhe etiketat e produkteve të ndërmarrjes i-Fire SHPK.

3. APP shprehet se, si pjesë e dosjes së Dokumenteve Standarde të Tenderit, një ndër dokumentet që u kërkohet operatorëve ekonomikë të paraqesin për tu kualifikuar në një procedure prokurimi është edhe “Deklarata për dorëzimin e ofertave të pavarura”. Qëllimi i dorëzimit të kësaj deklarate është identifikimi i marrëveshjeve të fshehta në ofertë, pasi këto marrëveshje të fshehta sjellin pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe përbejnë shkelje të rëndë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
4. Nisur nga parimi i nxitjes së konkurrencës, nëpërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe në kuadër të Memorandumit të bashkëpunimit nr. 28/2 prot., datë 02.04.2019 të nënshkruar me Autoritetin e Konkurrencës, APP ka përcjellë këtë rast për të vijuar më tej hetimin sa i takon kësaj çështjeje.
5. Në kuadër të vlerësimit të rastit, Autoriteti i Konkurrencës ka administruar informacion dhe dokumentacion nga APP, KESH SHA dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, lidhur me procedurat e prokurimit ku kanë marrë pjesë ndërmarrjet i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj gjatë periudhës 11 janar 2024 deri në 31 dhjetor 2025.
6. Nga verifikimi i ekstrakteve të QKB-së rezulton se Z. Aerd Mahmutaj ka qenë administrator i ndërmarrjes i-Fire SHPK deri më 04.01.2018 dhe ortak me 10% të kuotave deri më 04.01.2023. Gjithashtu, konstatohet se numri i celularit të Z. Aerd Mahmutaj vijon të figurojë në ekstraktin tregtar të ndërmarrjes i-Fire SHPK.
7. Nga analiza e të dhënave të depozituara nga APP rezulton se, ndërmarrja i-Fire SHPK ka marrë pjesë në 120 procedura prokurimi gjatë periudhës 11.01.2024–31.12.2025, ndërsa P.F. Aerd Mahmutaj ka marrë pjesë në 115 procedura prokurimi. Nga këto procedura, të dy subjektet kanë marrë pjesë njëkohësisht në 13 procedura prokurimi.
8. Nga analiza e procedurave të përbashkëta rezulton se në vitin 2025 ndërmarrja i-Fire SHPK nuk ka marrë pjesë në asnjë procedurë prokurimi, ndërkohë që P.F. Aerd Mahmutaj ka rritur ndjeshëm pjesëmarrjen e tij në procedurat e prokurimit public (102 procedura).
9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tenderit të administruar nga KESH dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike nuk rezulton të jenë konstatuar në ofertat e paraqitura

elementë identifikues të ndërmarrjes i-Fire SHPK, si emri, adresa, e-maili, numrat e kontaktit apo logoja e saj. Është konstatuar se këto të dhëna gjenden në formularët e ankesave të depozituara pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe jo në dokumentacionin e ofertave të procedurave të prokurimit.

10. Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet që kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe në Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, këto elementë ngrenë dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta ndërmjet operatorëve ekonomikë i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj.
11. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj ka elementë të një sjelljeje antikonkurruese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj.
 - II. Hetimi paraprak do të përfshijë periudhën kohore nga 11.01.2024 deri në 26.06.2026
 - III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
 - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1304, Datë 26.06.2026

“GJOBITJEN E NDËRMARRJES TIRANA ADMINISTRIM SHPK PËR MOS DHËNIEN E INFORMACIONIT NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1287, DATË 23.04.2026 “KËRKESË PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT NGA ANA E NDËRMARRJES TIRANA ADMINISTRIM SHPK””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.06.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Gjeditja e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK për mos dhënie e informacionit në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1287, datë 23.04.2026 “Kërkesë për sigurimin e informacionit nga ana e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK”.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 73, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE :

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Vendimit nr. 1145/2024, me shkresën nr. 97 prot., datë 29.01.2026, me objekt “Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1145, datë 27.12.2024”, i është drejtuar ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK duke kërkuar informacion lidhur me zbatimin e pikës (IV), (V) dhe (VI) të VKK nr. 1145, datë 27.12.2024, me afat për kthim - përgjigje brenda datës 23.01.2026. Ndërmarrja Tirana Administrim SHPK nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.
2. Në vijim, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 97/1 prot., datë 17.03.2026, me objekt “Rikujtesë mbi kërkesën për informacion të AK nr. 97 prot., datë 29.01.2026”, i është drejtuar sërish ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK duke i kërkuar

vënien në dispozicion të të dhënave të mësipërme brenda datës 27.03.2026. Edhe ndaj kësaj kërkesë, ndërmarrja nuk ka paraqitur asnjë përgjigje.

3. Gjithashtu, me email-in e datës 30.03.2026 (protokolluar me nr. 97/2 prot., datë 30.03.2026), me objekt “Kërkesë për dhënie informacioni dhe rikujtesë mbi detyrimet ligjore”, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës i është drejtuar përsëri ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK, duke kërkuar sigurimin e informacionit të kërkuar brenda datës 03.04.2026. Edhe kësaj here, ndërmarrja nuk i është përgjigjur kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1287, datë 23.04.2026 “Kërkesë për sigurimin e informacionit nga ana e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK”, vendosi:
 - I. T’i kërkojë ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin lidhur me zbatimin e pikës (IV), (V) dhe (VI) të Vendimit nr. 1145, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë gjobitjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK”.
 - II. Informacioni i përcaktuar në pikën I, duhet të dorëzohet brenda afatit 15 ditë nga dita që ky vendim është njoftuar.
 - III. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në dispozitivin I dhe II të këtij vendimi, ndërmarrja Tirana Administrim SHPK ndëshkohet me gjobë në masën deri në 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003.
5. Ndërmarrja Tirana Administrim SHPK nëpërmjet shkresës nr. 97/6 prot., datë 14.05.2026 “Plotësim i kërkesave të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1287, datë 23.04.2026, njoftuar me shkresën nr. prot. 97/5 datë 24.04.2026, me lëndë “Dërgim Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 1287, datë 23.04.2026”, si dhe kërkesë për pezullimin e procedurës së monitorimit deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë”, ka bërë me dije si vijon:
 - Ka rishikuar kontratat me operatorët e internetit për t’i përshtatur me kërkesat e Autoritetit të Konkurrencës dhe pretendon se nuk kufizon aksesin e asnjë operatori interneti në pallatet/rezidencat që administron;
 - Ka bashkëngjitur si provë një kontratë me operatorin XXX;

- Pretendon se pikat IV, V dhe VI të Vendimit nr. 1145/2024 nuk janë ende të formës së prerë, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është ankimuar në Apel;
 - Argumenton se, për sa kohë çështja është ende në shqyrtim gjyqësor, Autoriteti nuk mund të kërkojë zbatimin e masave korrigjuese për këto pika;
 - Kërkon zyrtarisht pezullimin e procedurës së monitorimit të zbatimit të pikave IV, V dhe VI deri në përfundimin e procesit në Gjykatën Administrative të Apelit me vendim të formës së prerë;
 - Shton se zbatimi i menjëhershëm i këtyre pikave do të cenonte sigurinë juridike, të drejtën për mbrojtje gjyqësore efektive dhe parimin e proporcionalitetit.
6. Informacioni i paraqitur nga ndërmarrja Tirana Administrim SHPK nuk provon përmbushjen e detyrimit për rishikimin e kontratave, pasi edhe sipas VKK nr. 1145/2024 janë evidentuar, konkretisht: (i) aplikim i tarifave të ndryshme dhe diskriminuese ndaj operatorëve të internetit për akses në të njëjtën infrastrukturë fizike në komplekse të ndryshme rezidenciale; (ii) parashikimi në kontrata i detyrimit për heqjen e infrastrukturës fizike në përfundim të kontratës, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi; (iii) përcaktimi i operatorëve preferencialë për t'u referuar tek banorët e rezidencave, duke krijuar trajtim të pabarabartë ndërmjet operatorëve. Këto sjellje janë vlerësuar nga Komisioni i Konkurrencës si sjellje që përbëjnë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2 germa (c) dhe (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.
7. Pretendimet e paraqitura nga ndërmarrja Tirana Administrim SHPK lidhur me pezullimin e procedurës së monitorimit dhe moszbatimin e pikave IV, V dhe VI të Vendimit nr. 1145, datë 27.12.2024, nuk qëndrojnë, pasi nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton të jetë marrë nga Gjykata Administrative e Apelit një masë sigurimi apo një vendim i ndërmjetëm që të pezullojë efektet juridike të kushteve dhe detyrimeve të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës.
8. Në këto kushte, vetëm ekzistenca e një procesi gjyqësor apo ushtrimi i së drejtës së ankimit nuk sjell automatikisht pezullimin e efekteve juridike të vendimit administrativ, për aq kohë sa nuk ekziston një vendim gjyqësor i shprehur që të disponojë pezullimin e zbatimit të tij. Për rrjedhojë, Autoriteti i Konkurrencës vijon të ushtrojë kompetencat e tij ligjore për monitorimin dhe vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjes në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003.
9. Vlerësohet gjithashtu se informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga ndërmarrja Tirana Administrim SHPK nuk është i plotë dhe nuk provon përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në Vendimin nr. 1145, datë 27.12.2024, pasi nuk evidentohet rishikimi i plotë të gjitha kontratave të konstatuara si në kundërshtim të nenit 9, germa (c) dhe (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.

10. Për më tepër, kërkesa për informacion dhe procedura e monitorimit kanë karakter administrativ dhe synojnë verifikimin e respektimit të kushteve dhe detyrimeve të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës, pa paragjykuar shqyrtimin gjyqësor të çështjes në themel.
11. Në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003, Komisioni vendos gjobë në masën jo më shumë se 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, ndaj ndërmarrjeve që nuk japin informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në vendimin e komisionit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 73, pika 1, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Gjykitjen e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK në masën 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 177,650 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Lekë.
- II. Ndërmarrja Tirana Administrim SHPK duhet të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin lidhur me zbatimin e pikës (IV), (V) dhe (VI) të Vendimit nr. 1145, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë gjykitjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK”, brenda afatit 15 ditor nga dita që ky vendim është njoftuar.
- III. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi, ndërmarrja Tirana Administrim SHPK ndëshkohet me gjobë periodike ditore jo më shumë se 5 për qind të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1305, Datë 26.06.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË PREDUZEĆE ZA PROIZVODNJU USLUGE I PROMET UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO, ARANDELOVAC NGA SHOQËRIA WIENERBERGER DOO KANJIŽA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.06.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë PREDUZEĆE ZA PROIZVODNJU USLUGE I PROMET UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO, ARANDELOVAC nga shoqëria WIENERBERGER doo KANJIŽA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit vetëm të shoqërisë PREDUZEĆE ZA PROIZVODNJU USLUGE I PROMET UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO, ARANDELOVAC nga shoqëria WIENERBERGER doo KANJIŽA”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë PREDUZEĆE ZA PROIZVODNJU USLUGE I PROMET

UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO, ARANDELOVAC nga shoqëria WIENERBERGER doo KANJIŽA.

2. Referuar dokumentit “Marrëveshje për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve”, nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: WIENERBERGER doo KANJIŽA** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Serbisë. Ajo operon në fushën e prodhimit të tullave, tjegullave dhe lëndëve të ndërtimit prej argjile të pjekur. WIENERBERGER doo KANJIŽA është pjesë e Grupit të shoqërive WIENERBERGER, një furnizues ndërkombëtar i materialeve të ndërtimit dhe të zgjidhjeve të infrastrukturës. Portofoli i produkteve të tij përfshin, në veçanti sisteme tubacionesh, materiale fasadash, materiale për mbulim çatish, materiale për ndërtimin e mureve, pllaka shtrimi dhe sisteme diellore.
4. Wienerberger AG është në të njëjtën kohë shoqëria mbajtëse (holding) e të gjithë grupit të blerësve dhe si shoqëri e listuar në bursë, me aksione tërësisht në qarkullim të lirë.
5. Grupi i blerësit nuk ka filiale në Shqipëri dhe të gjitha shitjet në Shqipëri bëhen përmes shoqërive WIENERBERGER të vendosura në vendet prodhuese.
6. **Shitësit: z. Z. S.** dhe **z. B. S.**, individ të cilët zotërojnë secili nga një kuotë prej 50% në kapitalin e shoqërisë target.
7. **Shoqëria target:** PREDUZEĆE ZA PROIZVODNJU USLUGE I PROMET UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO, ARANDELOVAC/ UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO ARANDELOVAC është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar, sipas legjislacionit të Serbisë, e cila ka aktivitetet të saj prodhimin e tullave prej balte.
8. Shoqëria target zotëron plotësisht dhe filialin e saj, subjekt i këtij transaksioni, të cilat janë kryesisht aktive në Serbi dhe në një masë të vogël në Shqipëri, Bosnjë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Hungari, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Rumani.
9. **Dega e shoqërisë target:** PRIVREDNO DRUŠTVO ZA PROIZVODNJU I PRODAJU GRADEVINSKOG MATERIJALA UNIVERZUM CIGLANA DOO ARANDELOVAC është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Serbisë.
10. Target Group nuk ka filial në Shqipëri dhe gjeneron xhiro të papërfillshme në Shqipëri (nga shitje shumë të kufizuara të tullave prej balte).

II. Përqendrimi

11. Më datë 13 maj 2026, ndërmjet palëve, shoqërisë WIENERBERGER doo KANJIŽA (blerësi), z. Zoran Spasojević (shitësi 1) dhe z. Branko Spasojević (shitësi 2), është lidhur marrëveshje lidhur me blerjen e 100% të aksioneve në shoqërinë target PREDUZEĆE ZA PROIZVODNJU USLUGE I PROMET UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO ARANDELOVAC.

12. Referuar kësaj Marrëveshje dhe në përputhje me termat, duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara, shitësit synojnë t'i shesin dhe t'i transferojnë aksionet tek blerësi dhe blerësi synon t'i blejë si më poshtë:
13. Hapi i Parë: [...].
14. Pas përfundimit të hapi të parë dhe regjistrimit të ndryshimeve përkatëse në strukturën e aksionarëve të shoqërisë target, blerësi do të mbajë një aksion në shoqërinë target që korrespondon me xx% të të gjithë kapitalit aksionar të shoqërisë target, Shitësi 1 do të mbajë xx% të aksioneve dhe shitësi 2 do të mbajë xx% të aksioneve.
15. Hapi i Dytë: [...]
16. Pas përfundimit të hapi të dytë dhe regjistrimit të ndryshimeve përkatëse në strukturën e aksionarëve të shoqërisë target, blerësi do të jetë aksionar i vetëm në shoqërinë target që korrespondon me 100% të të gjithë kapitalit aksionar të shoqërisë target.
17. Pas përfundimit të hapi të parë dhe të dytë, në përputhje me termat, duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, shoqëria target do të mbetet aksionar i vetëm i Degës së Shoqërisë Target. Palët kanë parashikuar përfundimin e transaksionit brenda vitit [...].
18. Rrjedhimisht, pas realizimit të transaksionit, blerësi do të blejë nga shitësi gjithsej 100% të aksioneve në shoqërinë target.
19. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë PREDUZEĆE ZA PROIZVODNJU USLUGE I PROMET UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO, ARANDELOVAC, nga shoqëria WIENERBERGER doo KANJIZA, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Analiza e konkurrencës

20. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe shitjes së materialeve të ndërtimit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
21. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimi e kontrollit të shoqërisë PREDUZECE ZA PROIZVODNJU USLUGE I PROMET UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO, ARANDELOVAC nga shoqëria WIENERBERGER doo KANJIZA.

22. Grupi i Blerësit nuk ka filiale në Shqipëri dhe të gjitha shitjet bëhen përmes shoqërive Wienerberger. Në Shqipëri Grupi i blerësit shet produktet e tij zakonisht materiale të ndërtimit në kantiere.
23. Grupi Target nuk ka filiale në Shqipëri dhe gjeneron xhiro të papërfillshme në Shqipëri (nga shitje shumë të kufizuar të tullave prej balte).
24. Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë PREDUZEĆE ZA PROIZVODNJU USLUGE I PROMET UNIVERZUM EXPORT-IMPORT DOO, ARANDELOVAC nga shoqëria WIENERBERGER doo KANJIŽA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1306, Datë 26.06.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË MAK MECSEK AUTÓPÁLYA KONCESSZIÓS ZÁRTKÖRÜEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG NGA SHOQËRITË STRABAG AG DHE ABERDEEN INFRASTRUCTURE (HOLDCO) V-A B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.06.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëritë STRABAG AG dhe Aberdeen Infrastructure (Holdco) V-A B.V.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëritë STRABAG AG dhe Aberdeen Infrastructure (Holdco) V-A B.V.”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëritë STRABAG AG dhe Aberdeen Infrastructure (Holdco) V-A B.V.

2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:

Blerësi:

3. **STRABAG AG** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Austrisë, me objekt aktiviteti ndërtimin industrial, ndërtimin e rrugëve dhe tuneleve, urave, hidrocentraleve dhe veprave të tjera të inxhinierisë civile, ndërtim rezidencash dhe banesash, si dhe zhvillimin e pasurive të paluajtshme dhe realizimin e projekteve të biznesit.
4. STRABAG AG është pjesë e Strabag Group, i cili është prezent në Shqipëri nëpërmjet:
 - STRABAG SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ndërtim, projektim të veprave të ndryshme; projektim dhe zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore, arkitekturës, menaxhim i mbetjeve jo të rrezikshme.
 - Degë e shoqërisë së huaj “STRABAG AG”, e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ndërtim, tregtim, teknologji informacioni, investime, agjenci imobiliare, riciklim mbeturina.
5. **Aberdeen Infrastructure (Holdco) V-A B.V.** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Holandës, me objekt aktiviteti: aktivitete të shoqërive holding. Aberdeen Infrastructure (Holdco) V-A B.V. është pjesë e Aberdeen Group, një grup ndërkombëtar i shërbimeve financiare dhe menaxhimit të aseteve.
6. Aberdeen Group nuk ka aktivitete biznesi, nuk gjeneron të ardhura dhe nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri.
7. **Shitësi: [...]**
8. **Shoqëria target: MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság** është një shoqëri hungareze koncesionare për qëllime të veçanta, aktivitetet e të cilës janë të kufizuara në funksionimin, menaxhimin e zonës së saj të koncesionit në Hungari.
9. [...]
10. Referuar deklaratës së palës njoftuese, sipas marrëveshjes aktuale të aksionarëve ndërmjet Strabag, Aberdeen Group dhe shitësit, Bordi aktual përbëhet nga shtatë anëtarë, ndërsa vendimet strategjike (përfshirë miratimin e buxhetit vjetor dhe emërimin / shkarkimin e menaxhmentit) kërkojnë pesë nga shtatë votat aktuale të Bordit. Prandaj në përputhje me Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, Strabag Group ka kontroll (negativ) të vetëm mbi target pasi dy aksionerët e tjerë zotërojnë vetëm 4 anëtar të Bordit.
11. [...]

12. Target nuk ka aktivitet biznesi, nuk gjeneron të ardhura dhe nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri.

II. Përqendrimi

13. Më datë 27 prill 2026 palët kanë lidhur këto kontrata:

a. [...]

b. [...]

c. [...]

14. [...]

15. [...]

16. [...]

17. Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” në pikën 1.5 të tij përcakton nëse transaksionet janë të ndërruara, pra të kushtëzuara në mënyrë të tillë që një transaksion nuk do të ishte kryer pa tjetrin. Një kushtëzim i tillë zakonisht përcaktohet kur transaksionet janë të lidhura *de jure* (d.m.th marrëveshjet në vetvete janë të lidhura përmes kushtëzimit të ndërsjellë), por mund të përcaktohet gjithashtu kur transaksionet janë të lidhura *de facto* (me kusht që një varësi e tillë të mund të vërtetohet). Një tregues kyç i ndërruorisë së disa transaksioneve është nënshkrimi i njëkohshëm i marrëveshjeve përkatëse.

18. Sipas deklaratës së palës njoftuese, blerësit vërejnë se: 1) [...]; 2) [...]; 3) [...]; 4) [...]; 5)[...]. Duke marrë parasysh sa më sipër, transaksioni përbën një përqendrim të vetëm.

19. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëritë STRABAG AG dhe Aberdeen Infrastructure (Holdco) V-A B.V., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

20. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu për menaxhimin e infrastrukturës së transportit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

21. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëritë STRABAG AG dhe Aberdeen Infrastructure (Holdco) V-A B.V.
22. STRABAG AG është një shoqëri, aktive në ndërtimin industrial, ndërtimin e rrugëve dhe tuneleve, ndërtimi i urave, hidrocentraleve dhe veprave të tjera inxhinierike civile, ndërtim rezidencash dhe banesash, si dhe zhvillimi i pasurive të paluajtshme dhe realizimi i projekteve të biznesit. STRABAG AG është pjesë e Grupit Strabag, Grupit Strabag është prezent dhe realizon të ardhura në Shqipëri përmes Degës së shoqërisë së huaj “STRABAG AG” dhe filialit të saj STRABAG SHPK, të cilët operojnë në tregun e ndërtimit, projektimit të veprave të ndryshme.
23. Aberdeen Infrastructure (Holdco) V-A B.V është një shoqëri holding, pjesë e Aberdeen Group. Aberdeen Group nuk është prezent dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.
24. Shoqëria target, MAK Mecsek Ltd. është një shoqëri koncesionare për qëllime të veçanta. Aktivitetet e saj kufizohen në menaxhimin e zonës së saj të koncesionit në Hungari.
25. Nga sa më sipër, konstatohet se asnjë nga palët nuk është aktive në tregun përkatës, tregun e menaxhimit të infrastrukturës së transportit në Shqipëri, dhe transaksioni nuk çon në mbivendosje midis aktivitetit të Palëve në tregun shqiptar.
26. Transaksioni i Propozuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëritë STRABAG AG dhe Aberdeen Infrastructure (Holdco) V-A B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS**

2026

BULETINI ZYRTAR



2026